



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 23.01.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për procedurën e verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

*10. Erjon Muharremaj (anëtar)*

*11. Marçela Shehu (anëtare)*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 6. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Erion Fejzulla, USAID.*
- 10. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 12. Ama Kraja, OSCE.*
- 13. Përfaqësues të medias.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për procedurën e verifikimit të plotësisimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit”.

**Naureda Llagami:** Atëherë, përshëndetje!

Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftuar për datën 23.01.2020.

Siç jeni në dijeni nga rendi i ditës, sot Këshilli i Lartë Gjyqësor do marrë në shqyrtim 12 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrje. Por përpara se të kalojmë në rendin e ditës për të cilin ju jeni njoftuar, unë dëshiroj t'ju propozoj që të shtohet në rendin e ditës edhe një çështje urgjente, e cila ka të bëjë me caktimin e një gjyqtari në Gjykatën e Apelit. Jemi dakord me këtë shtesë në rendin e ditës?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Atëherë, kalojmë në prezantimin e rendit të ditës.

Si çështje e parë për rend të ditës është: Shqyrtimi i projektvendimit lidhur me procedurën e verifikimit dhe plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit për kandidatët për kancelar, këshilltar ligjor për në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit.

Çështja e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me caktimin dhe publikimin e numrit maksimal të kandidateve magjistratë, profili gjyqtar, që do të pranohen në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Çështja e tretë e rendit të ditës ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit lidhur me kërkesën e {...} për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistrates në Gjykatën e Lartë.

Çështja e katërt e rendit të ditës ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtarit {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit”.

Çështja e pestë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, {...}”.

Çështja e gjashtë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. Ndue Gjura, Nëpunës Përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Çështja e shtatë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Durrës, {...}”.

Çështja e tetë ka të bëjë me dhënien e opinionit “Mbi kandidatët që kanë aplikuar për t’u komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e nëntë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për sa i përket gjyqtarit zotit {...}.

Çështja e dhjetë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe transferimin e gjyqtares {...}”.

Çështja e njëmbëdhjetë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtares {...}”.

Dhe çështja e fundit është shqyrtimi i projektvendimit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të: Kandidates {...}.

Pra shtohet edhe çështja e fundit e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Përpara se të kalojmë në relatimin e çështjes së parë nga relatori i çështjes, zotit Ilir Toska, i kërkoj kameramanëve të largohen nga salla dhe i ftoj gazetarët të ulen në ambientet e Këshillit.

*(Kameramanët dalin nga salla e mbledhjes.)*

Atëherë, siç ju bëra me dije, shqyrtimi i çështjes së parë nga ana e Këshillit ka të bëjë me projektvendimin “Për procedurën e verifikimit dhe plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor për në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit”. Ky projekt-akt, pa diskutim vjen sot në përmbushje të një detyrimi të rëndësishëm ligjor, të parashikuar nga ligji Për organet e qeverisjes por edhe nga ligji “Për pushtetin gjyqësor”. Ky projekt-akt do sigurojë qëndrimin në sistemin gjyqësor dhe emërimin sot e tutje të atyre nëpunësve të lartë

gjqësor ku përfshihen kancelarë, këshilltarë dhe ndihmës, vetëm mbi bazë integriteti të lartë moral, profesional dhe pasurisë.

Projekti ka parashikuar në detaje të gjithë procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pasurisë dhe figurës për këto kandidatë. Me anë të këtij akti i hapet rruga edhe fillimit të menjëhershëm të procesit të verifikimit të këtyre kandidatëve, ashtu si edhe do krijohet një bazë e rëndësishme rregullash qëndrimesh të unifikuar dhe për të gjithë kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë, si për ata që janë në detyrë dhe për ata që emërohen.

Për më shumë detaje, ia jap fjalën relatorit të projekt-aktit, zotit Ilir Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka marrë përsipër të bëjë një projektvendim lidhur me procedurën e verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në Gjykatën e Apelit.

Në fakt, procesi më herët, lidhur me draftimin e një projektvendimi për këtë procedurë verifikimi e ka iniciuar Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Është bërë një draft. Referuar atij drafti, ne si Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, meqenëse kishim një eksperiencë të mëparshme sa i përket procedurave të verifikimit për rekrutimin e gjyqtarëve, konsideruam që të konsiderojmë një procedurë më të plotë për të gjitha subjektet që përmenden në krye të projekt-aktit, që ka të bëjë me kancelarët, këshilltarët ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe ndihmësit ligjorë në gjykatat e apelit.

Vlerësuam që përtej propozimit/draftit që kishte bërë Komisioni i Planifikimit Strategjik, do duhet të përfshiheshin më shumë kategori subjektsh, kjo referuar detyrimin që na jep ligji për të bërë verifikimin e të gjithë këtyre subjekteve që janë emërtesë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërkohë që do të ndjekim të njëjtën procedurë standarde të verifikimit qoftë për gjyqtarët, ashtu edhe për të gjithë nëpunësit e tjerë që janë pjesë e sistemit gjyqësor, sa kohë, në obligim të ligjit, do duhet të konsiderojmë rikthimin e besimit publik në sistemin e drejtësisë, ku pjesë e të cilit janë edhe të gjithë subjektet që

bën fjalë projektvendimi.

Në thelb, projektvendimi ka të njëjtat procedura që ne kemi përcaktuar për verifikimin e gjyqtarëve, qoftë për rekrutimin e tyre, qoftë për ngritje në detyrë. Nuk ka ndonjë risi në atë aspekt. I vetmi diskutim që ka mbetur mes nesh, jashtë mbledhjes plenare, është nëse ligji përcakton qartësisht të gjitha subjektet që janë përfshirë në këtë projektvendim. Pra nëse kemi një përcaktim të shprehur ligjor që t'i përfshijmë të gjithë kategoritë. Bëhet fjalë që ligji, në mënyrë të shprehur ka përcaktuar kancelarët në detyrë që do t'i nënshtrohen verifikimit, përfshirë edhe kriterit të pasurisë dhe figurës, ka përcaktim ligjor që rregullon verifikimin e kriterit të pasurisë dhe figurës edhe për ndihmësit ligjorë, të cilët janë subjekt rivlerësimi kalimtar. Por në nenin 53/9, ligji bën fjalë për verifikimin e çdo kandidati (pra kancelar, këshilltar ligjor apo ndihmës ligjor, përpara pranimit të tyre në sistem. E vetmja paqartësi, të themi, apo ometim nga ligji është që nuk është e përcaktuar në mënyrë definitive, që ky verifikim konsiston në verifikimin e kriterit të pasurisë dhe të figurës.

Në frymën e legjislacionit për reformën në drejtësi Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka konsideruar që kjo frymë dhe dispozitat që bëjnë fjalë për ata që janë në detyrë, obligohen që kushdo nga subjektet e kësaj kategorie që do të hyjë në sistemin gjyqësor, do duhet të ndjekin një procedurë standarde verifikimi, pra të njëjtën procedurë.

Ky është pak a shumë projektvendimi. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin, pavarësisht se ne e kemi diskutuar midis nesh për një kohë shumë të gjatë.

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, diskutimi im lidhur me projekt-aktin është në parim, lidhur së pari me subjektet që janë objekt i këtij rregullimi. Në bindjen time personale, ndaj të njëjtin mendim si zoti Toska që, jo vetëm ata që janë pjesë, që kanë qenë pjesë e sistemit gjyqësor për kategorinë e kancelarëve apo ndihmësve ligjorë aktual dhe këshilltarëve, duhet të kalojnë testin e verifikimit të asetëve, të pasurisë pra dhe të figurës, por edhe çdo individ ose çdo kandidat që aplikon për këto pozicione. Por kjo mbetet një bindje personale sepse në vlerësimin tim nuk është ajo çka parashikohet në ligj dhe për të detajuar më tej mendimin, do t'i referohem jo vetëm dispozitave të ligjit "Për

organizimin e pushtetit gjyqësor”, por dispozitave për sa i përket ligjit për Statusin, por edhe dispozitave të ligjit që rregullon veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive.

Në nenin 53 të ligjit për Statusin, të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, është e vetmja dispozitë ku parashikohet detyra e Këshillit për të kryer verifikimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës për kategorinë e kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë. Kjo dispozitë zbatohet për të gjitha këto kategori që aplikojnë për herë të parë për t’u futur në sistem, sepse për kancelarët në detyrë ka një dispozitë tranzitore e cila në mënyrë të shprehur e parashikon si kriter kalimin e testit ose e verifikimit të pasurisë dhe të figurës dhe po kështu, edhe për ndihmësit ligjorë aktual dhe këshilltarët ligjorë në Gjykatën e Lartë, parashikohet shprehimisht që ata janë subjekt të ligjit për Rivlerësimin.

Pra, diskutimi im është vetëm lidhur me rrethin e subjekteve që kanë të bëjnë me pozicionin kancelar, këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor në gjykatat e apelit që aplikojnë rishtazi për këto pozicione, nëpërmjet aplikimit të tyre, për të ndjekur trajnimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

Neni 53, në pikën 4, parashikon që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka për detyrë të verifikojë nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës. Duke iu referuar dispozitave të tjera të ligjit, në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, nuk përmendet detyrimi për të kaluar në procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës.

Nga ana tjetër, po t’i referohemi nenit 53, pika 9, parashikohet që Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të hollësishme për mënyrën e përlllogaritjes së numrit të kandidatëve që pranohen në programin e formimit fillestar dhe verifikimin e kandidatëve që pranohen në provimin e pranimit. Pra jo verifikimi i kandidatëve që kanë kaluar provimin e pranimit.

Duke interpretuar të dyja këto dispozita, në vlerësimin tim, ligji nuk e parashikon detyrën ose të themi, kompetencën e Këshillit, që të kryejë për këtë kategori subjektsh edhe verifikimin e pasurisë edhe verifikimin e figurës.

Në aspekt të parimit të ligjshmërisë dhe atë çka Kushtetuta parashikon që ligji duhet të parashikojë jo vetëm organin por edhe kompetencën dhe t’ia delegojë ai organit detyrën për të rregulluar një specifike ose një fushë të caktuar, në këtë rast ligji nuk e detyron Këshillin e Lartë Gjyqësor jo vetëm që të kryejë verifikim të pasurisë dhe të figurës por as të përcaktojë kritere të tjera shtesë që lidhen me rekrutimin e këtyre kandidatëve. Kjo për sa i përket fazës së parë të pranimit në provimin e formimit fillestar.

Nga ana tjetër, kjo rregullore shkoi edhe më tej. Sipas rregullores është parashikuar që në momentin që kandidatët futen në provim ose kandidojnë për t’u futur në provim, bëhet thjesht një verifikim i kushteve të përgjithshme të veçanta. Në momentin e dytë kur kandidatët kalojnë provimin, ata i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, që në vlerësimin tim është tejkalim i kompetencave që ligji i jep KLGJ-së. Me tej parashikohet që, në momentin që kandidatët mbarojnë periudhën e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, përkatësisht 9-mujore për ndihmësit ligjorë dhe 3-mujore për këshilltarët, përsëri do t’i nënshtrohen një verifikimi pasurie dhe figure, duke ndjekur të njëjtin standard si për gjyqtarët, që edhe kjo në vlerësimin tim është tejkalim i kompetencave të ligjit.

Jo vetëm për çka arsyetova, por edhe për një fakt tjetër, sepse me këtë rregullore shtohet numri i subjekteve që ILDKP-ja ka për verifikim pasurie sipas ligjit të saj të posaçëm.

Në qoftë se do t’i referohemi ndryshimeve ligjore që janë bërë në ligjin, mbi të cilin aktualisht, që ka ligjin organik Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive, në nenin 3, pika 1, ndryshimet që kanë ndodhur në vitin 2017, parashikohen se cilët janë kandidatët për pozicione të caktuara brenda sistemit, të cilët i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës.

Atëherë, thotë neni 3, pika 1 është shtuar pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të ligjeve, thotë: Deklarim i pasurisë për kandidatët për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë – pika /a/ “a. kandidatët që shprehin interesin për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, etj.”; pika /b/ “b. kandidatët që shprehin interesin për ILD”; pika /c/ “c. kandidatët për pranim në formimin fillestar të Shkollës së



Magjistraturës, si dhe i diplomuari që kandidon për t'u emëruar magjistrat, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”; pika /ç/ “ç. kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme...”, mandej kategoritë nuk lidhen me subjektet që kemi.

Në vlerësimin tim, shtimi i kësaj liste subjektsh, pra kancelarët e rinj, nëpunësit gjyqësor të rinj, këshilltarët e rinj për në Gjykatë të Lartë, do të shtojë automatikisht dhe do të ndryshojë rrethin e subjekteve parashikuar në nenin 3, pika 1, të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe detyrimeve financiare...”, është ligji organik mbi të cilin vepron ILD-ja (*është fjala për ligjin organik të ILDKPI*).

Nisur nga ky arsyetim, vlerësoj që për sa i përket rrethit të subjekteve, rregullorja duhet të parashikojë rregullime të detajuara për atë çka ligji e detyron dhe që është neni 53, pika 9 dhe duhet të përjashtojmë, në këtë moment të paktën, rregullimet për sa i përket pozicioneve për kancelarë, këshilltarë ligjorë apo ndihmës ligjorë që aplikojnë për pozicione të reja.

Në vlerësimin tim është ometim i ligjit, nuk është paqartësi. Për këtë arsye vlerësoj që në momentin që ligji, dhe është në proces aktualisht ndryshimesh, do ta reflektojë këtë ndryshim, në atë moment ne mund të nxjerrim aktet tona nënligjore për këtë grup subjektsh.

Kjo ishte për sa i përket rrethit të subjekteve që rregullon rregullorja.

Mandej pastaj kam edhe diskutime të tjera lidhur me fazën në të cilën kalon procesi i verifikimit të pasurisë së figurës, por këto janë të lidhura me propozimin e parë, që nëse do të ngushtohet rrethi i subjekteve, nuk do të ketë më nevojë për ta diskutuar pjesën tjetër.

Edhe diskutim tjetër është edhe lidhur me Komisionet që do të kryejnë verifikimin e pasurisë dhe të figurës dhe do të kryejnë edhe verifikimin e kritereve ligjore (kushteve dhe kritereve), sepse në rregullore parashikohet që do të ketë një Komision të Posaçëm për verifikimin e kancelarëve në detyrë, një Komision tjetër të Posaçëm për verifikimin e kancelarëve të tjerë të rinj që do aplikojnë, ndihmësve ligjorë dhe këshilltarëve, dhe një Komision tjetër që është Komisioni i Karrierës, i cili përjashtohet nga ky. Pra, ndoshta do

të ishte më mirë të refkletoheshë mënyra e Komisionit që duhet të kryejë këtë procedurë, për ta kryer në shpejtësi dhe në efikasitet, që të mos kemi konsumim të të gjithë anëtarëve për të kryer thjesht verifikimin e pasurisë dhe të figurës.

Por, ajo që shtroj unë për diskutim është nëse duhet të përfshihen kancelarët e rinj, domethënë kandidatët që kandidojnë për pozicionin e kancelarit, të ndihmësit ligjor apo të këshilltarit ligjor, në procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës. Vlerësoj që nuk mund të jenë pjesë e rregullores.

**Naureda Llagami:** Atëherë, për të qenë më konkret lidhur me propozimin që bëri zonja Ukperaj. Fillimisht, ju jeni me idenë që të kalojmë në propozim për sa i përket çështjes nëse do jetë rrethi i subjekteve ai i propozuar nga ana e Komisionit në draft rregullore apo do jetë i kufizuar, atë që ju pretendoni lidhur me kancelarët në detyrë?

**Brikena Ukperaj:** Pra vetëm për pjesën e kancelarëve në detyrë dhe ndoshta rregulla më të hollësishme për sa i përket procedurave të verifikimit për nëpunësit gjyqësorë civilë në gjykatat e posaçme sepse dihet që ata i nënshtrohen kësaj procedure, kryhen nga një Komision i Posaçëm sipas ligjit specifik, por edhe Këshilli ka kompetencat e veta. Pra rregullorja duhet të përfshijë për sa i përket kancelarëve në detyrë, verifikimit, të themi angazhimit që ka Këshilli në procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për nëpunësit gjyqësorë civilë të gjykatave të posaçme dhe pastaj vetëm për sa i përket kritereve të veçanta dhe të përgjithshme për subjektet e tjera, jo pasuri dhe figurë.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Kalojmë në propozimin e bërë nga zonja Ukperaj, duke qenë se ky është një propozim i cili nëse pranohet nga Këshilli, duhet të reflektohet në draftin e rregullores.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Kundër.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Kundër.

*(Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet.)*

**Erjon Muharremaj:** Kundër.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Kundër.

Kalojmë tani në pjesën e Komisionit. Lidhur me pjesën e Komisionit, zonja Ukperaj dëshironi që të bëni propozim konkret?

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, propozimi konkret është: Meqenëse u pranua që edhe këto subjekte do të jenë pjesë e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës, kam sugjerime dhe komente lidhur me... Tani, po e them pyetjen: - Sa herë do t'i nënshtrohet kancelari i ri që aplikon, ndihmësi i ri ligjor, këshilltari, procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës? Sepse, sipas rregullores, i nënshtrohet pasi e kalon provimin e Shkollës së Magjistraturës dhe pas 9 muajsh apo 3 muajsh i nënshtrohet përsëri, ndërkohë që vetë ligji për deklarimin e pasurive, parashikon që nëse brenda 110 ditëve e ka kaluar dhe nuk ka rezultuar me probleme, nuk është i nevojshëm të bëhet një kontroll i dytë.

**Ilir Toska:** Pyetja?

**Brikena Ukperaj:** Ishte që, -sa herë do t'i nënshtrohen kontrollit të pasurisë dhe të figurës referuar ligjit për deklarimin e pasurive? Sepse është parashikuar dy herë.

**Ilir Toska:** Atëherë, siç thatë edhe ju, rregullorja është parashikuar i njëjti standard, qoftë në hyrje, qoftë edhe në dalje nga shkolla. Nuk ka ndonjë periudhë tremujore shkolla. Ka periudhë 9-mujore për ndihmësit dhe këshilltarët dhe 3-vjeçare për kancelarët.

Nëse mendoni se s' do duhet të bëjmë një nga këto dy procedura, mund të bëni një propozim konkret ku duhet të ndërhyhet të modifikohet.

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, propozimi im është që nëse do të pranojmë dhe e pranuar si Këshill që kancelarët, ndihmësit ligjorë dhe këshilltarët do kalojnë testin e verifikimit të pasurisë dhe figurës para fillimit të programit të trajnimit fillestar, nuk ka sens që ta kalojnë edhe në përfundim të këtij trajnimi sepse kancelarët e kanë trajnimin vetëm 3 muaj, ndërkohë që ndihmësit ligjorë e kanë 9 muaj. Dhe nëse do t'i referohemi

edhe dispozitave të ligjit që unë citova nenit 3/1, nuk përmendet as gjekundi që i diplomuari ose personi që kalon programin e trajnimit fillestar për kancelar, ndihmës ligjor apo këshilltar, t'i nënshtrohet verifikimit të pasurisë.

Po pra, të mos i bëhet momentin e dytë. Propozoj që t'i bëhet një herë.

...momenti i pranimit në Shkollën e Magjistraturës, pra kur ai e fillon programin e trajnimit fillestar. Atëherë fillon. Sepse ka disa momente. Momenti i parë është momenti i pranimit në provim ku verifikohen kushtet e përgjithshme, kriteret e veçanta. Momenti i dytë është kur ai e ka fituar provimin dhe do fillojë shkollën. Mendoj që në këtë moment t'i bëhet edhe verifikimi i pasurisë dhe të figurës sepse ka edhe sens. Nuk ka sens që të bëjë 9 muaj dhe pastaj t'i bëhet në fund. Dhe ky të jetë ezaures. Të mos kemi më pas plotësimit të tre muajve apo pas nëntë muajve. Ky është propozimi.

**Naureda Llagami:** Atëherë, hedhim në votim propozimin?

**Maksim Qoku:** Jo! Vetëm diçka desha të them.

Ligji për Rivlerësimin ka një afat 180 ditë (6 muaj).

*(Disa nga anëtarët ndërhyjnë pa ndezur mikrofonat.)*

Më fal, "Për ILDKPI-në".

Kështu që, aspekti i konstatimit 3 muaj herë 3 është 90 ditë dhe ne e dimë për pasojë se ç'bëhet dhe nëse kalohet mbi 6 muaj, pra mbi 180 ditë, ne e dimë që ai do futet në një kontroll. Kështu që ne mund të zbatojmë edhe ligjin në këtë aspekt. Pra nuk e fusim dy herë sepse procedurën e zbatojmë por konstatojmë që është një kontroll i bërë brenda 3 muajve, pra është brenda 180 ditëve, sikurse për aspektin tjetër të ligjit, nëse kalohet 180 ditë, ai do hyjë në kontroll. Vetëm këtë desha që të...

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Meqenëse janë periudhat e shkurtra të shkollimit, mund të konsiderojmë që të bëjmë vetëm një verifikim. Sa i përket 180 ditë-shit, kjo nuk është çështje që i përket vetë organeve, përfshi edhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, por është çështje që i përket organit të kontrollit. Ai mund të konsiderojë nëse ka bërë kontrollin, brenda 180 ditëve, të mos bëjë një kontroll të plotë pasurie. Por nuk e pengon ligji që të bëjë përsëri një kontroll. Kjo është çështje e vlerësimit të atij autoriteti. Domethënë për

këtë nuk ndërhyt Këshilli.

Jam dakord me parimin që të bëjmë edhe një verifikim referuar periudhave të shkurtra, mbase do të ishte më oportune dhe do të ishte mirë të bënim një verifikim në hyrje.

**Naureda Llagami:** Atëherë, në qoftë se nga Komisioni pranohet ky sugjerim i bërë nga anëtarja apo..., keni nevojë që ta kalojmë në votim?

**Ilir Toska:** Unë dhashë opinionin tim.

Nëse Këshilli konsideron se duhen dy, do ta vendosë Këshilli. Nëse Këshilli vendos që duhet vetëm një dhe do ta reflektojmë, është po Këshilli që do ta bëjë këtë gjë.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Hedhim në votim propozimin e bërë nga zonja Ukperaj?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë, duke marrë në konsideratë që Këshilli vlerësoi propozimin e bërë nga zonja Ukperaj, nga ana e Komisionit mund të reflektohet dhe ta shtyjë vendimmarrjen?

Okej! Atëherë, nga ana e Komisionit të reflektohet pasqyrimi i këtij rekomandimi bërë nga zonja Ukperaj dhe rregulloren, pavarësisht se e kemi kaluar në parim, për pjesën e përmbajtjes, e kalojmë në seancën e ardhshme të mbledhjes plenare.

**Brikena Ukperaj:** Meqenëse rregullorja do i nënshtrohet edhe një herë shqyrtimit dhe pasqyrimin të ndryshimeve, unë do të propozoj që të ishte një Komision që do ta

kryejë këtë procedurë. Okej, le të jetë edhe i përkohshëm, 1-vjeçar siç është përmendur. Por të ishte i njëjti Komision që bën edhe kancelarët në detyrë edhe kandidatët e rinj për kancelarë, për ndihmësit ligjorë dhe këshilltarët sepse rregullorja parashikon dy Komisione të ndryshme me anëtarë të ndryshëm, të ndryshëm këta nga Komisioni i Karrierës. Vlerësoj që duhet të jetë një Komision që duhet ta bëjë këtë procedurë. Le të jetë i ndryshëm nga Komisioni i Karrierës, nga Komisioni i Përhershëm sepse kështu është parashikuar në rregullore. Komisioni le të jetë 1-vjeçar, por të jetë një Komision edhe për kancelarët në detyrë. Sepse ky i kancelarëve në detyrë do kryhet vetëm një herë dhe është vetëm këtë vit. Nuk do jetë më vitet e tjera.

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Që të jap arsyet pse menduam ashtu.

E kemi menduar që të ketë disa komisione, që të shpërndahet ngarkesa e punës, që të jemi efektiv. Nëse mendoni që një Komision mund ta bëjë edhe është efektiv, ka një propozim konkret, e miraton Këshilli dhe mbaron me një Komision. Ne konsideruam për shkak të asaj eksperience që kishim vet si Komision, që të ishin të angazhuar sa më shumë anëtarë, që t'i mbarojmë sa më shpejt procedurat, se jemi shumë me vonesë. Nëse mendoni që një Komision është aq efektiv sa t'i mbarojë në kohë të gjitha procedurat... Konsideroni kancelarët në detyrë që janë sot dhe ata që do të hyjnë në shkollë, por edhe ata që janë në shkollë (se janë edhe disa që janë në shkollë nga kjo kategori subjektsh), do duhet të bëhet një sahat e më parë verifikimi. Prandaj është menduar që të jenë disa komisione.

Por nëse Këshilli mendoj që një Komision është i mjaftueshëm, kjo është një gjë që rregullohet dhe e vendos Këshilli. Faleminderit!

**Marçela Shehu:** Unë ju rikujtoj, siç tha zoti Toska, nga eksperiencia me verifikimin e kandidatëve për magistratë dhe për verifikimin e kandidatëve për Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, procesi i verifikimit është një proces shumë kompleks, që zgjat në kohë, ka procedura që zgjasin. Kështu që, përfshirja e shumë anëtarëve do të ishte shumë më efektive për t'i dhënë rrugë procesit.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi më diskutime?

Ta hedhim në votim propozimin?

Okej, shqyrtimi i rregullores kalon në seancën e radhës.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 23.01.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Caktimi dhe publikimi i numrit maksimal të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtar, që do të pranohen në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)



**11. Marçela Shehu**

**(anëtare)**

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 6. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 7. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 8. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 9. Erion Fejzulla, USAID.**
- 10. Gregor Borkowski, EURALIUS.**
- 12. Ama Kraja, OSCE.**

#### **RENDI I DITËS:**

2. Caktimi dhe publikimi i numrit maksimal të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtar, që do të pranohen në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë me caktimin dhe publikimin e numrit maksimal të kandidateve magjistratë, profili gjyqtarë, që do të pranohen në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik

2020-2021. Relator i këtij projekt-akti është zoti Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit një projektvendim lidhur me numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Ky projektvendim gjen mbështetje në nenin 29 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit në janar të çdo viti, Këshilli i Lartë Gjyqësor do duhet të përcaktojë dhe publikojë numrin maksimal të kandidatëve magjistratë që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik.

Për të qenë sa më efektiv në përcaktimin e numrit të kandidatëve për magjistratë në profilin gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021, duhet të mbajmë në konsideratë disa faktorë, analizimin e situatës në të cilën është sistemi gjyqësor, dhe ndikimi që ka implementimi i reformës në drejtësi, mundësia që ka Shkolla e Magjistraturës, ashtu si dhe projektimi, vizioni i Këshillit për gjyqësorin në një periudhë afatgjatë.

Ndaj, sa më sipër, në caktimin e numrit të magjistratëve që duhet t’i dërgohen Shkollës së Magjistraturës, janë mbajtur në konsideratë: së pari - vendet vakante për gjyqtar që aktualisht ka në sistemin gjyqësor; së dyti - vendet vakante për ndihmës ligjorë që aktualisht ka në sistemin gjyqësor; së treti - vendet vakante për këshilltar ligjorë që aktualisht ka në Gjykatën e Lartë; së katërti - numri i kandidatëve për magjistratë që pritet të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës gjatë viteve 2020-2022; së pesti - numri i kandidatëve për ndihmës ligjorë që pritet të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës gjatë vitit 2020; po kështu edhe numri i kandidatëve për këshilltarë ligjorë që pritet të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës gjatë këtij viti; së shtati – mbahet në konsideratë numri i gjyqtarëve që mbushin moshën për pension pleqërie (65 vjeç) gjatë viteve 2020-2023 apo dhe moshën për mbarimin e statusit të magjistratit (67 vjeç) në këto vite; së teti – mbahet në konsideratë historiku i vendimmarrjeve për shkarkim nga detyra të gjyqtarëve/ndihmësve lidhorë dhe këshilltarëve ligjorë nga organet e rivlerësimit kalimtar në kuadër të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga rezulton një numër i madh vendimesh të

tilla; së nënti – mbahet në konsideratë ngarkesa në gjykata, trendi i saj, por edhe afatet ligjore dhe ato të arsyeshme në raport me atë që kërkohet për efijencën e gjykatave dhe të gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, e lidhur kjo edhe me miratimin gjatë këtij viti të hartës së re gjyqësore, që në funksion të garantimit të aksesit në drejtësi, të uljes së kostove dhe rritjes së cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara, konsideron një organizim të ri gjyqësor përmes krijimit të gjykatave më të mëdha në numër gjyqtarësh dhe kompetencash tokësore dhe suprimimin e atyre që nuk përlligjin ekzistencën, çka do të sillte dhe shpërndarje të drejtë te ngarkesës së punës për gjyqtar, ku të gjithë këta faktorë vlerësohet se do të çojnë në rritjen e nevojës për gjyqtarë; së dhjeti – mbahet në konsideratë mundësia e shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve/ndihmësve ligjorë apo këshilltarëve ligjorë si pasojë e një procesi disiplinor nga Këshilli i Lartë Gjyqësor apo edhe efektet ligjore në rastet e procedimeve penale ndaj tyre; së njëmbëdhjeti – mbahet në konsideratë dhe mundësia e bërjes efektive të skemës së delegimit të gjyqtarëve sipas nenit 45 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që nënkupton shkëputjen e një numri të caktuar gjyqtarësh nga gjykata dhe atashimin/komandimin në skemën e delegimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me qëllim për të përmbushur nevojat e gjykatave për çështje apo periudha të veçanta.

Sa i përket vendeve vakant për gjyqtarë, bazuar në numrin total të organikës së gjykatave të shkallës së parë, parashikuar në Dekretin e Presidentit të Republikës të vitit 2012, po kështu edhe për gjykatat e apelit si dhe ligjit “Për Gjykatën e Lartë”, rezulton që aktualisht të jenë vende vakante të përhershme 30 në gjykatat e shkallës së parë. Në gjykatat e apelit janë 21 vende vakante të përhershme. Ndërkohë që Gjykata e Lartë ka 14 vende vakante. Duke pasur në konsideratë që një nga anëtarët e Gjykatës së Lartë, zoti Medi Bici ushtron funksionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në total në sistem janë 65 vende vakant.

Po t’i zbresim këtij numri edhe numrin e magjistratëve 15 që do t’i caktojmë në pozicion, pra që kemi bërë emërimin në datën 9 janar 2020, mbetet që sistemi ka vakancë për 50 vende.

Vlen të mbahet në konsideratë fakti se aktualisht janë të komanduar në Këshillin e

Lartë Gjyqësor 3 magjistratë: 2 pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme dhe 1 si Nëpunës Përgjegjës për Vlerësimin Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve. Këshilli i Lartë Gjyqësor në përbërje të tij ka 6 gjyqtarë të niveleve të ndryshme, por ky numër, pra qoftë ata që janë komanduar, qoftë edhe për sa i përket numrit të anëtarëve, janë përfshirë në përlllogaritjen e vakancave si më lart. Janë edhe 5 magjistratë që e ushtrojnë për momentin detyrën e Nëpunësit Përgjegjës për vlerësimin në Këshillin e Lartë Gjyqësor, që mund të konsiderohet se ata do duhet të caktohen në pozicione në gjykatat përkatëse në periudhën në vijim.

Sa i përket vendeve vakant për ndihmës ligjorë, pranë gjykatave të apelit, sipas ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, ligjit nr.98/2016, do të funksionojnë njësitë e shërbimit ligjor, që përbëhen nga ndihmësit ligjorë, që do të krijohen me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sipas ligjit, numri i ndihmësve ligjorë nuk mund të jetë më i madh se gjysma e numrit të gjyqtarëve në gjykatë. Sipas organikës aktuale, Gjykatat e Apelit kanë 102 gjyqtarë e për rrjedhojë numri i ndihmësve ligjorë që duhet të jenë në sistem është 51.

Aktualisht, numri i ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative është 19. Dhe këta do duhet të sistemohen pranë gjykatave të apelit.

Në lidhje me vendet vakante për këshilltarë ligjorë, Gjykata e Lartë ka në organikën e saj 19 gjyqtarë.

Prej muajit tetor të vitit 2018 në Gjykatën e Lartë ushtrojnë detyrën e këshilltarëve ligjorë pranë trupës gjyqësore vetëm 9 (nëntë) të tillë, nga të cilët 4 (katër) janë ndihmës magjistratë dhe 5 (pesë) janë këshilltarë ligjorë (pra jomagjistratë).

Pranë Gjykatës së Lartë ende nuk është ngritur “Njësia e Shërbimit Ligjor”, në të cilën, sipas ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Pra, sipas organikës aktuale të Gjykatës së Lartë, numri i këshilltarëve ligjorë nuk mund të jetë më pak se 9 (mbi principin se çdo gjyqtar një ndihmësmagjistrat apo

këshilltar ligjor), ndërkohë që sipas ligjit ky numër do të përcaktohet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë kur kjo të bëhet funksionale.

Sa i përket numrit të magjistratëve që pritet të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës - Në korrik të vitit 2020 diplomohen 13 kandidatë magjistratë, profili gjyqtar, si dhe 6 kandidatë magjistratë, profili gjyqtar, që janë subjekte përfshirë ex officio. Në total, në vitin 2020, priten të diplomohen 19 kandidatë për magjistratë, profili gjyqtar.

Në vitin 2021 nuk pritet të diplomohet asnjë kandidat për magjistratë, profili gjyqtar, pasi në vitin 2018 nuk ka filluar programin e formimit fillestar asnjë kandidat.

Në vitin 2022 priten të diplomohen 26 kandidatë për magjistratë, profili gjyqtar.

Lidhur me numrin e ndihmësve ligjorë që pritet të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës - Në vitin 2020 priten të diplomohen 8 ndihmës ligjorë.

Ndërsa, sa i përket këshilltarëve ligjorë, priten të diplomohen në vitin 2020 4 këshilltarë ligjorë.

Lidhur me numrin e gjyqtarëve që mbushin moshën e pensionit të pleqërisë apo atë të mbarimit të statusit të magjistratit, periudha e studimit ka përfshirë vitet 2020-2023. Në këtë periudhë, numri i gjyqtarëve që mund të ndërpresin ushtrimin e detyrës me dorëheqje për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë, në total është 24, e shpërndarë sipas këtyre viteve: Në vitin 2020 - 1 gjyqtar; Në vitin 2021 - 8 gjyqtarë; Në vitin 2022 - 4 gjyqtarë; Në vitin 2023 - 11 gjyqtarë.

Ndërkohë, sa i përket numrit të gjyqtarëve që mbushin moshën për mbarimin e statusit të magjistratit (pra 67 vjeç), për këtë periudhë në total është 10: Në vitin 2020 – nuk ka gjyqtarë që mbushin moshën 67 vjeç; Në vitin 2021 është vetëm 1 gjyqtar; Po kështu edhe në vitin 2022; Ndërsa në vitin 2023 janë 8 gjyqtarë.

Lidhur me dorëheqjet e gjyqtarëve, viti 2019 është karakterizuar nga një numër i madh dorëheqjesh të gjyqtarëve në detyrë. Konkretisht në vitin 2019 kanë dhënë dorëheqjen 17 gjyqtarë, dhe është deklaruar mbarimi i statusit të magjistratit nga KLGJ deri në janar të vitit 2020, ndërsa janë në proces trajtimit edhe dorëheqjet e 3 gjyqtarëve të tjerë. Ndërkohë që ky trend dorëheqjesh mund të vijojë edhe përgjatë vitit 2020 apo

edhe në vitet e mëpasshme.

Shkarkimi si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, ka shkarkuar nga detyra 47 gjyqtarë.

Ndërkohë në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, bazuar po në të njëjtin ligj, janë shkarkuar me vendim të formës së prerë 20 gjyqtarë. Vetëm për 2 gjyqtarë të kualifikuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendimet e kësaj të fundit janë lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Siç dihet, legjislacioni ka parashikuar që vendim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Deri në pritjen e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, këto gjyqtarë, pezullohen nga ushtrimi i detyrës, parashikuar specifikisht në nenin 62 të ligjit nr. 84/2016. Aktualisht janë në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelit 26 gjyqtarë. Në këtë numër nuk janë përfshirë vendimet e dhëna në periudhën e fundit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, të cilat nuk janë zbardhur ende dhe për rrjedhojë nuk ka filluar ende edhe procesi i ankimit të tyre.

Nga ana tjetër, për një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar.

Nga të dhënat, tendenca e deritanishme tregon se rreth 40% e gjyqtarëve janë shkarkuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, prandaj është e domosdoshme që ky tregues të mbahet në vëmendje për të ardhmen, në mënyrë që procesi aktual i rekrutimeve të mund të pakësojë pasojat negative në funksionimin e sistemit gjyqësor në një të ardhme të afërt, pra efektet që mund të vijnë nga procesi i rivlerësimit kalimtar gjatë dy viteve në vazhdim të mund të kapërcehen përmes rekrutimit të një numri të mjaftueshëm kandidatësh për magjistratë, profili gjyqtar.

Mbi kapacitetin që ka Shkolla e Magjistraturës - Me shkresën nr. 37 prot., datë 14.01.2020, me lëndë “Mbi vendet vakante për kandidatët për magjistratë, të profilit gjyqtarë dhe kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë në Programin e Formimit Fillestar, viti 2020-2021”, Shkolla e Magjistraturës informon se sipas Strategjisë

Afatmesme, Shkolla e Magjistraturës ka bërë parashikimin se: “KLGJ-ja dhe KLP-ja caktojnë numrin e vendeve vakante. Për shkak të procesit të vetingut, nevojat e sistemit mund të jenë të mëdha, por, për vetëm për vitin 2019, Shkolla nuk mund të rekrutojë më shumë se 50 kandidatë në vit (me një prirje për rritje të arsyeshme prej 25 kandidatësh çdo vit), për disa arsye:

a) Së pari, për shkak të numrit të vogël dhe jo cilësor të kandidatëve që konkurrojnë për të marrë pjesë në konkurs e pranimit dhe b) Së dyti, për shkak të pamundësisë së rekrutimit të trupës pedagogjike me kohë të pjesshme, e cila duhet të jetë e një niveli të lartë profesional dhe moscenimit, në këtë mënyrë, të mësimdhënies”.

Për sa më sipër, numri maksimal i kandidatëve për magjistratë, për të dy profilet, që Shkolla e Magjistraturës mund të pranojë për vitin akademik 2020-2021, është gjithsej 75 (shtatëdhjetë e pesë). Gjithashtu në këtë strategji janë bërë edhe parashikimet për rekrutimin e kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, sipas së cilës, Shkolla parashikon të ofrojë formimin fillestar për një klasë jo më shumë se 25 kandidatë çdo vit.

Siç edhe konstatohet nga shkresa e ardhur nga Shkolla e Magjistraturës, kapaciteti i saj është i kufizuar, 100 (njëqind) duke përfshirë kandidatët për magjistratë (gjuqtarë dhe prokurorë) si dhe këshilltarë dhe ndihmës ligjorë. Ndërkohë, duke qenë se Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 59, pika 1 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, është organi kompetent edhe për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor në gjykata, përveç caktimit të numrit të magjistratëve për vitin e ri akademik, Këshilli duhet të kujdeset dhe të caktojë edhe numrin e këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë.

Vlen të mbahet në konsideratë se brenda numrit maksimal të kandidatëve për magjistratë, për të dy profilet, që Shkolla e Magjistraturës mund të pranojë për vitin akademik 2020-2021, pra 75 (shtatëdhjetë e pesë), Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin datës 15.01.2020, ka përcaktuar në 35 numrin maksimal të kandidatëve për magjistratë, profili prokuror, që Shkolla e Magjistraturës mund të pranojë për këtë vit akademik. Pra, mbeten 40 numrin maksimal të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të përcaktojë për t’u pranuar në Shkollën e

Magjistraturës për vitin akademik 2020-2021.

Lidhur me projektvendimin, projekti parashikon që numri i kandidatëve për magjistratë, për profilin gjyqtar, që pas kalimit të testit profesional, do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020 - 2021, të jetë 40 (dyzet), ndërkohë që numri i kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që pas kalimit të këtij testi profesional, do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, po për vitin akademik 2020 - 2021, të jetë 25 (njëzet e pesë).

Gjithashtu propozohet që nëse nuk ka kërkesa që plotësojnë numrin e planifikuar të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, kuotat e parashikuara për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, do t'i shtohen kandidatëve për magjistratë të profilit gjyqtar. Në rast se në renditjen përfundimtare të testimit profesional ka konkurrentë mbi numrin 65 (gjashtëdhjetë e pesë), që sipas Rregullores së Brendshme të Shkollës kanë arritur pikët e nevojshme për kandidatët për magjistratë, kuotat e planifikuara për këshilltarë apo ndihmës ligjorë mund t'i shtohen numrit të përgjithshëm të kandidatëve për magjistratë, të profilit gjyqtar, duke pasur kujdes që në çdo rast, numri i kandidatëve të shtuar për magjistratë, të cilët kanë aplikuar për profilin gjyqtar, nuk mund të kalojë numrin e planifikuar.

Në rast se nga konkurrentët nuk arrihen pikët që nevojiten për kandidatët për magjistratë, vendet e mbetura mund t'i shtohen numrit të përgjithshëm të kandidatëve që kanë aplikuar për këshilltarë apo ndihmës ligjorë, të cilët plotësojnë nivelin minimum të pikëve që parashikohen në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

Projektvendimi parashikon gjithashtu edhe publikimin që duhet të bëjë Shkolla e Magjistraturës, e cila bëhet brenda një jave kalendarike nga data e publikimit të numrit maksimal të kandidatëve për magjistratë, për profilin gjyqtar. Thirrje bëhet nëpërmjet: në faqen zyrtare të Këshillit dhe të Shkollës së Magjistraturës; si dhe në të paktën një prej gazetave me tirazh më të lartë në vend.

Ndërkohë Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatët e interesuar për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë për paraqitjen e kërkesave për formim fillestar, nëpërmjet njoftimeve



të publikuara: pranë gjithë gjykatave; si dhe në faqet zyrtare të gjykatave, të Këshillit të Lartë Gjyqësor apo edhe të Shkollës së Magjistraturës.

Afati për paraqitjen e kërkesave për formimin fillestar, nga kandidatët e interesuar për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, është parashikuar deri më datën 29 shkurt 2020.

Projektvendimi ka të parashikuar edhe kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjor, sikundër edhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë ata që të pranohen në provimin e pranimit.

Në projektvendim është parashikuar dhe dokumentacioni që duhet të paraqesë kandidati në momentin e aplikimit.

Në përfundim projektvendimi përcakton që procesi i regjistrimit për konkurrim i kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë kryhet në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, dhe se kandidatët që plotësojnë kriteret, i nënshtrohen konkursit të pranimit, duke paguar tarifën e regjistrimit për pjesëmarrjen në konkurs sipas Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet edhe momenti i hyrjes në fuqi i vendimit, pikërisht në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni?

Po, zoti Muharremaj!

**Erjon Muharremaj:** Faleminderit!

Kisha një propozim, për një ndryshim të vogël në përmbajtjen e pikës 4 të projektvendimit sepse personalisht, kështu siç është formuluar, më krijohet përshtypja sikur Shkolla e Magjistraturës është institucioni që përcakton përmbajtjen e informacionit që hidhet në faqet zyrtare të gjykatave dhe të vetë Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht, citoj, pika 4: “4. Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatët e interesuar për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë për paraqitjen e kërkesave për formim fillestar, nëpërmjet njoftimeve të publikuara: a) pranë gjithë gjykatave; b) në faqet zyrtare të gjykatave, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Shkollës së Magjistraturës.”

Propozimi im konkret për formulimin e kësaj pike është ky, pika 4: “4. Kandidatët e interesuar për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë marrin dijeni për paraqitjen e kërkesave për formim fillestar, nëpërmjet njoftimeve të publikuara: a) pranë gjithë gjykatave; b) në faqet zyrtare të gjykatave, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Shkollës së Magjistraturës.” Ky është propozimi im. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toska!

Shqetësimi që ka zoti Muharremaj mendoj se mund të jetë shqetësim hipotetik.

Nuk mundet që shkolla të administrojë faqet as të gjykatave, as të Këshillit. Shkolla në çdo rast do duhet t'i kërkojë Këshillit që ta publikojë atë njoftimin, siç kemi bërë edhe vitin e kaluar. Nuk besoj se kemi ndonjë rrezik, se është një eksperiencë e kaluar kjo gjë.

**Brikena Ukperaj:** Të shtoj edhe diçka.

Ajo që thotë zoti Muharremaj, ndoshta në mënyrën e formulimit të fjalisë mund të ngjallte interpretim, por në fakt, ajo çka parashikohet është motamo ajo që parashikon neni 53, pika 3. Vet ligji thotë “Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatët e interesuar për paraqitjen e kërkesave për formim fillestar, nëpërmjet njoftimeve të publikuara: a) pranë të gjitha gjykatave; b) në faqet zyrtare të gjykatave, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Shkollës së Magjistraturës. Është vet parashikimi ligjor, ajo që është vendosur në projektvendim.

**Naureda Llagami:** Atëherë, faleminderit!

Kalojmë propozimin e zotit Muharremaj për votim dhe më pas...

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Kundër.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Kundër.

***Medi Bici:*** Kundër.

***Naureda Llagami:*** Kundër.

Atëherë, hedhim në votim propozimin e bërë nga Komisioni.

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Illir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Pro.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, këshilli vendosi numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 23.01.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për kërkesën e znj. {...} për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistrates në Gjykatën e Lartë” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 6. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Erion Fejzulla, USAID.*
- 10. Gregor Borkowski, EUR{...}S.*
- 12. Ama Kraja, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kërkesën e znj. {...} për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistrates në Gjykatën e Lartë” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin tjetër që do marrim në shqyrtim, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit lidhur me kërkesën e znj. {...}për

komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistrates në Gjykatën e Lartë, projekt-akt i cili është i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do relatohet nga zoti Alban Toro.

***Alban Toro:*** Po! Faleminderit!

Atëherë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar shkresa e Gjykatës së Lartë me nr.64 prot., datë 09.01.2019, me anë të së cilës kërkohet dhe jepet pëlqimi që znj. {...} të komandohet pranë Gjykatës së Lartë me qëllim shtimin e numrit aktual të ndihmësve ligjore.

Znj. {...}, më 18.10.2018, i është drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë duke shprehur interesin për t'u sistemuar si ndihmësmagjistrate në strukturat e Gjykatës së Lartë.

Fillimet e saj zonja {...} i ka me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.3983, datë 21.10.2003 në të cilën përcaktohet se studentët e Shkollës së Magjistraturës, ndër të tjerë edhe zonja {...}, që kanë përfunduar vitin e dytë, emërohen gjyqtarë dhe do të kryejnë stazhin profesional në Gjykatat e Shkalles së Parë sipas ndarjes së mëposhtme: ku zonja {...} është caktuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Më tej, me Dekretin e Presidentit të Republikës 4313, datë 16.09.2004 znj. {...} është caktuar si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë .

Me Vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.268, datë 15.09.2010 znj. {...} është emëruar inspektore në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndërkohë që në këtë gjykatë me Dekretin nr.6265, 16.09.2009, “Për caktimin e numrit të gjyqtareve, për çdo Gjykatë të Shkallës së Parë”, numri i gjyqtareve është përcaktuar në 7 (shtatë).

Me Dekretin nr.7818, datë 16.11.2012, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo Gjykatë të Shkallës së Parë, të Apelit dhe të Gjykatave Administrative, si edhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të Gjykatave Administrative” numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë është reduktuar në 4 (katër). Në momentin e daljes së këtij Dekreti, por dhe aktualisht, në këtë gjykatë kanë emërimin e përhershëm (janë caktuar në mënyrë të përhershme në kuptim të ligjit aktual në fuqi, Ligjit nr.96/2016), znj. {...}, z. {...}, z. {...}, i komanduar aktualisht si

ndihmësligjor/ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë dhe z. {...}, i pezulluar me vendimin nr.47, 29.04.2015 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Duke qenë që ky relacion daton nga korriku i vitit të kaluar, më duhet ta rifreskojmë me një informacion tjetër, ku në bazë të vendimit të këtij Këshilli datë 09.01.2020, për zotin {...} është konstatuar mbarimi i statusit, duke krijuar në të njëjtën kohë një vend të përhershëm pranë kësaj gjykate.

Me Vendimin e Këshillit të Lartë e Drejtësisë nr.411, datë 16.12.2013, “Për dhënien e pëlqimit znj. {...}, për të shërbyer si Avokate e Përgjithshme e Shtetit”, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur “Të japë pëlqimin që inspektore {...}, të shërbejë si Avokate e Përgjithshme Shteti në Ministrinë e Drejtësisë, duke e konsideruar të mbaruar mandatin e saj si inspektore pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”

Më tej kam vijuar me rregullimet, dispozitat ligjore që rregullojnë mandatin e magjistratit të komanduar në institucionet brenda sistemit të drejtësisë. Nuk po i citoj, pasi janë pasqyruar në relacion. Dhe po vijoj tek analiza e këtij institucioni, pra të komandimit të magjistratëve në institucionet brenda sistemit të drejtësisë.

Sistemi i garancive që gëzojnë gjyqtarët sanksionohet jo vetëm në dokumente ndërkombëtare ku ka aderuar Republika e Shqipërisë por edhe në disa nene të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 138 etj.). Në këtë kuadër Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve, në paragrafin 1.1, shprehet se statusi i gjyqtarëve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elementë këto që çdo individ i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve. Gjithashtu, “Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit” (miratuar me Rezolutat 40/32, 29 nëntor 1985 dhe 40/146, 13 dhjetor 1985 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së), në paragrafin 11, sanksionojnë se mandati i gjyqtarëve, pavarësia e tyre, siguria, paga e përshtatshme, kushtet e shërbimit, pensionet dhe mosha e daljes në pension duhet të sigurohen nga ligji në mënyrë të përshtatshme.

Në fakt, ligji i kohës kur Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka dhënë pëlqimin për komandimin e gjyqtarës {...}, konkretisht ligji nr.9877, 18.02.2008, garantonte në

dispozitat e tij të drejtat dhe detyrimet e gjyqtareve, pranimin dhe emërimin e tyre, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit, vlerësimin etik dhe profesional, përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile.

Sistemi i garancive në lidhje me ruajtjen e vendit të punës dhe, për rrjedhojë, edhe të statusit është pasqyruar edhe në rastet kur gjyqtari punonte në detyrën e jo gjyqtarit pranë një institucioni brenda sistemit të drejtësisë.

Konkretisht në nenin 28 të këtij ligji përcaktohet se:

“1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës.”

Të njëjtën frymë pasqyron edhe ligji aktual, 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj krahas parimeve të përgjithshme (Pjesa I, nenet 1-2) të cilat rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve (Pjesa II, nenet 3-27), ku gjejnë trajtim të veçantë papajtueshmëritë, kufizimet dhe veprimtaritë e tjera, paga dhe përfitimet e tjera financiare dhe shoqërore, leja dhe ulja e kohës së punës, si dhe të drejtat e tjera; zhvillimin e karrierës së magjistratëve në Pjesën III, nenet 28-67 rregullon çështje të rekrutimit të kandidatëve magjistratë, emërimin dhe caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, njëkohësisht edhe komandimin (neni 53 e vijues) mandati i kufizuar dhe mbarimi i statusit të magjistratit.

Dispozitat e ligjit të sipërcituar kanë pasqyruar vullnetin e kushtetutëbërësit (neni 138 i Kushtetutës) dhe ka integruar në të mekanizma që mbrojnë palëvizshmërinë, pagën, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit, në funksion të pavarësisë së gjyqësorit, integritetit dhe paanshmërisë së gjyqtarëve.

Nga aktet e administruara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë rezulton se znj. {...} rezulton e komanduar në pozicion jo magjistrati në një institucion brenda sistemit të drejtësisë nga viti 2010.



Konkretisht, me Vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.268, 15.09.2010, znj. {...} është emëruar inspektore në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Më tej, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr.411, datë 16.12.2013, “Për dhënien e pëlqimit znj. {...}, për të shërbyer si Avokate e Përgjithshme e Shtetit”, ka vendosur “Të japë pëlqimin që kjo e fundit të shërbejë si Avokate e Përgjithshme Shteti...”.

Duke iu referuar nenit 28 të ligjit të kohës kur gjyqtarja {...} është komanduar, afati i komandimit të fundit nuk duhet të ishte më shumë se 3 vjet dhe e zbatuar për rastin në shqyrtim, mbarimi i komandimit do të ishte data 16.12.2016.

Por, në nëntor të vitit 2016, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i cili, nëpërmjet dispozitave kalimtare, ka rregulluar situatat e krijuara para miratimit të tij. Edhe në këtë aspekt ky ligj ka paraparë të ruaj garancitë statutores të gjyqtarit, por edhe parimin e sigurisë juridike në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme, si dhe besueshmërisë së këtyre subjekteve tek shteti i së drejtës.

Konkretisht dispozita e nenit 167 e ligjit ndër të tjera përcaktojnë se:

“1. Për magjistratin e komanduar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zbatohen dispozitat e këtij ligji për aq sa është e mundur.

2. Magjistrati i komanduar me vendim të institucioneve të tjera, sipas parashikimeve të ligjit të mëparshëm, afati i komandimit të cilit mbaron para krijimit të Këshillave, kthehet në vendin e mëparshëm të punës.”

Me tej në nenin 53, ky ligj ka përcaktuar edhe një nga elementet e këtij instituti, atë të lidhur me afatin e komandimit. Më konkretisht “Periudha e komandimit të magjistratit nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në ligj. Magjistrati nuk mund të komandohet për më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës së tij”.

Në kushtet kur ky ligj rregullon edhe afatin e mbetur të znj. {...}, mbarimi i komandimit të fundit për të është data 16.12.2018. Në pikën 7 të kësaj dispozite, ligji ka përcaktuar edhe kufizim të komandimit të njëpasnjëshëm duke përcaktuar se “magjistrati

duhet të shërbejë jo më pak se pesë vjet si magjistrat pas periudhës së komandimit”.

Përfundimisht, znj. {...}, me përfundimin edhe të afatit 5-vjeçar të komandimit të dytë (për shkak të ligjit nr. 96/2016) për efekt të zhvillimit të karrierës si magjistrat, ka detyrimin, por edhe të drejtën, të shërbejë si magjistrat në pozicionin gjyqtar atje ku ajo është dekretuar, emëruar në mënyrë të përhershme, sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr.4313, 16.09.2014, pra në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Ky akt përfaqëson edhe detyrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, por edhe të drejtën e magjistrates, konform nenit 57, pika 4, të ligjit nr. 96/2016, në të cilën përcaktohet se: “Magjistrati ka të drejtë që pas periudhës të komandimit të kthehet në pozicionin e mëparshëm, përveçse në rastet kur parashikohet ndryshe në ligj”.

Pra, për shkak të efekteve të krijuara nga Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 7818, datë 16.11.2012, “Për caktimin e numrit të gjyqtareve për çdo Gjykatë të Shkallës së Parë, të Apelit dhe të Gjykatave Administrative, si edhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të Gjykatave Administrative”, si pasojë numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë u reduktua në 4, pra në atë numër sa në atë moment, në këtë gjykatë, ka pasur gjyqtarë në detyrë, të emëruar në mënyrë të përhershme, ku nuk përfshihej znj. {...}, rezulton se përmes këtij Dekreti të ishte suprimuar pozicioni i saj në këtë gjykatë.

Në këto kushte, pavarësisht mungesës së shprehur të një rregullimi ligjor në nenin 57 të ligjit nr. 96/2016, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbart detyrimin e përgjithshëm për realizimin e të drejtës se znj. {...} për caktimin e saj në një pozicion të lirë të përhershëm, ku vetëm në pamundësi të caktimit në një pozicion të tillë, si zgjidhje e përkohshme mund të shtrohet caktimi i saj në një pozicion të lirë të përkohshëm në pritje të hapjes së një pozicioni të lirë të përhershëm.

Pra ky diskutim më pas është bërë në kushtet kur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë nuk ka pasur një vend të lirë të përhershëm. Në kushtet kur, për shkak të vendimit të cituar, pra nr. 17, 09.01.2020 të zotit {...} i është konstatuar mbarimi i statusit, diskutimi i mëvonshëm më del pa vlerë sepse aktualisht, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka një pozicion të përhershëm të lirë. Kështu që po kaloj direkt tek propozimi i

Komisionit.

Mbi sa më lart i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor që, bazuar në nenet 4 dhe 147/1/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të ligjit 115/2016, si dhe në nenin 53, pikat 6 dhe 7, nenin 57, pikat 1 dhe 4, si edhe në nenin 167, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, t’i refuzojë kërkesën e magjistrates {...} për dhënie pëlqimi për komandimin e saj si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë; Të vendosë kthimin e znj. {...} në pozicionin e mëparshëm si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Pra kuptohet që relacioni vazhdon në kushtet kur ën atë kohë, pra në korrik të 2019-ës ishte konstatuar që nuk kishte një pozicion të lirë të përhershëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, ishte propozuar si metodë alternative të sistemimit në punë Durrësin, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, si gjykata afër vendit ku ajo kishte ushtruar në mënyrë të përhershme funksionin e magjistratit.

Ndërkohë një zhvillim tjetër është, me të cilin unë ju kam vënë në dijeni nëpërmjet e-maileve, është edhe një kërkesë e zonjës {...}, 06.01.2020, ajo kërkon ndër të tjera që t’i ruhet të drejtat e fituara në kuadër të sigurisë juridike dhe të drejtat e fituara si elementi pagë që ajo ka fituar si inspektore në KLD. Pra në pozicionin ku ju do ta përcaktoni, mundësisht t’i ruhet edhe elementi pagë që ajo ka patur si inspektore e KLD-së.

Kam tentuar të gjejë bazën ligjore, por për fat të keq nuk kam mundur dot. Kështu që... Është rast unik, -thotë. Dhe ju lutem të merrni në konsideratë për shkak të sigurisë juridike, cenimit të pagës, etj., etj. Një kopje të kësaj jua kam dërguar edhe juve.

Ku pak a shumë është edhe materiali i përgatitur.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar nga relatori dhe nga Komisioni?

**Ilir Toska:** Atëherë, ka dy kërkesa nga zonja {...}. Kërkesa e parë është që të komandohet në Gjykatën e Lartë, për të cilën do duhet të marrim një vendim dhe relatori

ka propozuar refuzimin e kësaj kërkesë. Dhe kërkesa e dytë që ishte si alternativë e kësaj ishte të sistemohem në një pozicion në sistemin gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, e hedhim në votim propozimin e parë.

Kemi diskutime njëherë lidhur me...?

Jo!

**Brunilda Kadi:** Nuk del tek relacioni kur ka përfunduar komandimin e dytë, në çfarë date konkretisht dhe në çfarë mënyre?

...thotë relacioni, -do të kishte përfunduar komandimin e dytë. Por realisht kur i ka mbaruar? Si është larguar nga detyra ku ishte? Komandimi i dytë, po. Sepse nuk del nga relacioni.

**Alban Toro:** Me urdhrin nr. 156, datë 22.10.2018, pra disa ditë më vonë se data 16 “Për lirim dhe emërimin në detyrë”, të Kryeministrit të asaj kohe, zonja {...} Avokat i Përgjithshëm i Shtetit të lirohet nga kjo detyrë.

**Brunilda Kadi:** Ku është?

Është në relacion?

**Alban Toro:** Janë zhvillime të mëtejshme. Se relacioni daton...

**Brunilda Kadi:** Pra nuk është në relacion kjo Alban.

**Alban Toro:** Jo, jo.

**Brunilda Kadi:** Sepse s’kam nga ta di.

**Alban Toro:** Pra afati i përlogaritur ishte data 16.

**Brunilda Kadi:** Jo, jo, doja të dija si i ka përfunduar?

**Alban Toro:** Si i ka përfunduar?

Është liruuar nga detyra.

**Brunilda Kadi:** Për çfarë arsye është liruuar.

**Alban Toro:** Nuk e thotë arsyen këtu. Relacionin nuk ma kanë dërguar.

**Brunilda Kadi:** Nuk ka rëndësi për ne ky fakt?

**Alban Toro:** Po lirimi është i barasvlershëm me dorëheqjen. Nuk është shkarkim.

**Brunilda Kadi:** Ku thuhet kjo?

**Alban Toro:** E drejta administrative, më duket se e ka.

**Ilir Toska:** Është ndryshe.

**Brunilda Kadi:** Po pra, të na e sqarojë në relacion pra mënyra si i ka përfunduar komandimi i dytë. Ndoshta duhet ta dimë ne. Se nuk del nga relacioni prandaj.

**Alban Toro:** Po pra, atë që citova edhe më lart, është liruar për shkak të dorëheqjes së saj nga detyra.

**Brunilda Kadi:** Nga cili nga aktet del ky fakt?

**Alban Toro:** Fakti i liritimit del nga urdhri i Kryeministrit.

**Brunilda Kadi:** Po! Dhe urdhri është i shoqëruar me akt, me aktin e dorëheqjes ose ...?

**Alban Toro:** Jo! Është vetëm urdhri.

**Brunilda Kadi:** Po nga e dini ju që ka dhënë dorëheqjen?

**Alban Toro:** Ajo është pjesë tjetër pastaj.

**Brunilda Kadi:** Nuk e dimë arsyen si i ka përfunduar komandimi. Është përfunduar në mënyrë natyrale, në përputhje me ligjin? Se mund të jetë edhe masë disiplinore. Nuk ka rëndësi për ne ky fakt?

**Alban Toro:** Atëherë, fakti i dorëheqjes, mënyra se si është mbaruar mandati i Avokates së Përgjithshme të Shtetit, i është kërkuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrit. Nga ky sekretariat ka ardhur vetëm urdhri i pashoqëruar me relacionin përkatës për mënyrën se si ka mbaruar.

**Brunilda Kadi:** Alban, mbase të na referosh, ose edhe zoti Toska, të na lexojë atë që mori përsipër të sqaronte që lirimi, në cilat raste ndodh. Në qoftë se duket qartë që nuk është një nga rastet që do na pengonte të ecnim më tutje, ecim. Se sikur thatë që lirimi është o dorëheqje, o diçka tjetër thatë? Pra nuk mund të jetë shkarkim ose masë disiplinore.

**Ilir Toska:** Mora përsipër të të thosha që lirimi është i ndryshëm nga shkarkimi. Shkarkimi është si pasojë e një procedure disiplinore, ndërsa lirimi s'është sipas një pasoje të një procedure disiplinore. Faleminderit!

**Brunilda Kadi:** Po qe se na i referoni dispozitën.

**Ilir Toska:** Kë dispozitë?

**Brunilda Kadi:** Ku e bazoni të gjithë këtë sqarim.

**Ilir Toska:** Legjislacioni në Republikën e Shqipërisë konsideron dy lloj përfundimesh marrëdhëniesh në shërbimin civil: me lirim ose me shkarkim. Shkarkimi është si pasojë e një procedure disiplinore, ndërsa lirimi nuk është i tillë, janë raste të ndryshme shkarkimi, raste të ndryshme lirimi. Mund të përfshihet dorëheqja, apo ku di unë.

**Brunilda Kadi:** Ju mendoni që nuk kas asnjë lloj rëndësie ta dimë në çfarë formë është bërë lirimi?

**Ilir Toska:** Rëndësi ka që ju të dini çdo gjë që ju mendoni se duhet të dini. Faleminderit!

**Brunilda Kadi:** E pra, prandaj e pyeta relatorin dhe ngaqë morët ju përsipër ta sqaronit edhe thashë mbase...

**Ilir Toska:** Mora përsipër të sqaroj termat. Se ishit duke u ngatërruar me termat.

**Brunilda Kadi:** Jo, jo. Termin nuk e ngatërroj unë.

Thjesht pyeta çfarë letrash ka. Meqë në relacion mungonte informacioni si është larguar nga detyra ose është duke e vazhduar akoma detyrën, se nuk e dimë këtë, nuk del nga relacioni. Thjesht pyeta.

**Alban Toro:** Pra dhe sqarimi t'u tha që me urdhër të Kryeministrit nr. dhe datë është liruar.

**Brunilda Kadi:** Dhe më pas, pyetja ishte: -Për çfarë arsye? Dhe po pres tani.

**Alban Toro:** Po pra, arsyen zyrtare mendoja ta kisha tek ai relacioni që kam kërkuar.

Në kushtet kur nuk e kam atë relacion, nuk mund ta pohoj nëse është dorëheqje apo një shkak tjetër. Por shkarkim nuk ka.

**Marçela Shehu:** Kam një propozim.

Nëse Këshilli vlerëson që ky informacion është i nevojshëm, para se Këshilli të shprehet lidhur me kërkesën e zonjës {...} dhe duke qenë se Komisioni vet e kishte vlerësuar marrjen e këtij informacioni por përgjigjja nuk ka ardhur, atëherë le të hidhet në

votim pikërisht ky propozim. Pra a duhet ta përsërisim kërkesën për informacion pranë Kryeministrit lidhur me shkakun e lirit nga detyra të zonjës {...}.

**Brunilda Kadi:** Okej! Unë mendoj që nëse Komisioni e ka vlerësuar për të marrë këtë informacion dhe nuk ka ardhur dhe përsëri e solli, do të thotë që për Komisionin është e ezauruar si procedurë. Kështu që s'ka kuptim në fakt kjo gjë. Nëse juve si Komision vlerësoni që vendimi i Kryeministrit për lirim, për shkak të legjislacionit shqiptar, siç e sqaroi zoti Toska, nuk ka lidhje me shkarkimin dhe nuk është pengesë për të ecur më tutje, ecim.

*(Anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)*

**Alban Toro:** Pika 3, neni 102 e Kushtetutës, pika 1 e nenit 21 dhe pika 4 të nenit 26 të ligjit 1018, datë 13.11.2008 “Për avokaturën e shtetit”.

**Brunilda Kadi:** Që?

**Alban Toro:** Që është baza ligjore.

**Brunilda Kadi:** Një pyetje kam për Komisionin, për relatorin.

Jo, jo. Një sekondë.

Se e nisa unë këtë diskutim. Ju të tjerët ishit të qartë si duket. Unë e bëra pyetjen sepse nuk e gjeta në relacion. Më duhet si fakt.

Nëse Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relatori dhe Komisioni, vlerësojnë që kjo është e mjaftueshme dhe kaq informacion sa kemi (urdhri i Kryeministrit për lirim) dhe nuk na duhet informacion tjetër pse është liruar?

Unë s'kam asnjë kundërshtim. Vazhdojmë. Nuk kam kërkesë unë.

**Alban Toro:** Atëherë, tek aktet bashkëngjitur praktikës, besoj duhet të ketë pasur edhe një vlerësim pune të bërë për zonjën {...} si avokaturë e përgjithshme e shtetit, ku nga Sekretari i Përgjithshëm i kësaj Kryeministrie.

**Brunilda Kadi:** Po, e kam lexuar. Janë vlerësime pozitive.

**Alban Toro:** Vlerësime pozitive dhe kjo daton me datën 17.10.2018. Ndërkohë që urdhri i lirit është 22.10.2018. Besoj që duhet të jetë shkak dorëheqja, ai fakti i largimit.

Nëse e shikoni të nevojshme të insistojmë, insistojmë, por...

**Brunilda Kadi:** E bëj të qartë që nuk kam as edhe një lloj kërkesë. E bëj të qartë që unë thjesht pyeta meqenëse në relacion nuk thuhesh në asnjë moment, i ka përfunduar apo jo, jo komandimi por, a është duke e ushtruar apo jo detyrën e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, meqenëse në relacion nuk dilte.

Ju e sqaruar. Unë jam e qartë. Dhe e qartësoj që nuk kam asnjë kërkesë.

**Marçela Shehu:** Ndërsa unë i qëndroj propozimit tim, duke qenë se, megjithëse pak a shumë anëtarët deklaruan që janë të qartë, por faktikisht shkak i largimit nuk është i qartë, nuk del i qartë.

Unë propozoj, që për të shmangur çdo lloj aludimi për mënyrën si është larguar zonja {...}, të shtyhet shqyrtimi i kërkesës dhe t'i kërkoher edhe një herë zyrtarisht institucionit përkatës që të na sjellë aktin që vërteton arsyen e largimit të zonjës {...} nga Avokati i Shtetit.

**Naureda Llagami:** Po, zonja Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, së pari dua të them që për Këshillin, është larguar apo është shkarkuar, nuk ka asnjë rëndësi për statusin, për sa kohë ajo nuk ka një procedim disiplinor para organit, nuk ka një procedim disiplinor në Këshill. Megjithatë, për të hequr çdo dilemë, do t'i referohesha ligjit. Tani në moment unë nuk e kam vënë në diskutim nëse do të kishte debat, por i referohem ligjit konkretisht, nenit 22 të Avokaturës së Shtetit, të cilën edhe Kryeministri e ka vendosur si bazë ligjore dhe jepen dy koncepte për Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, ligji thotë: Avokati i Përgjithshëm i Shtetit shkarkohet ose lirohet nga detyra me propozim të Kryeministrit, me vendim të Këshillit të Ministrave. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit lirohet nga detyra kur: jep dorëheqjen; mbush moshën e pensionit; mungon në detyrë për një periudhë më shumë se 3 muaj; i është hequr zotësia për të vepruar, etj. Pastaj parashikohet "shkarkohet nga detyra".

Referuar ligjit, bazën ligjore të vendosur nga Kryeministri dhe parashikimit të lirimit, mendoj që nuk jemi para shkarkimit.

Dua të them që nuk ka rëndësi për mua si anëtare, shkak pse është liruar nga detyra.



**Brunilda Kadi:** Edhe unë jam e qartë. Sepse tani më kujtohet edhe në një status publik që është bërë nga Kryeministri, ka sqaruar që arsyeja e lirit të zonjës {...} ka qenë dorëheqja e saj. Ky është fakt i njohur botërisht sepse është bërë publik qëndrimi i Kryeministrit, kështu që. Unë thjesht bëra pyetjen, se nuk ishte në relacion ky fakt.

**Naureda Llagami:** Do e hedhim në propozim kërkesën e bërë nga...

Po! E gjykon që është e nevojshme.

Atëherë, hedhim propozimin për të kërkuar informacione lidhur me shkakun e lirit, pavarësisht sqarimeve që u dhanë.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** E sqarova. Jam kundër.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Kundër.

*(Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet. Por ishte propozuesja.)*

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Medi Bici:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Kundër.

Atëherë, kalojmë tek propozimi i bërë nga Komisioni.

Kemi diskutime lidhur me propozimin e bërë nga Komisioni? Projekt-akti?

Propozimi i parë. Kalojmë në votim propozimin e parë të bërë nga Komisioni? Që konsiston në: Të refuzohet kërkesa e magjistrates {...} për dhënie pëlqimi për komandimi e saj si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.

**Brunilda Kadi:** Kam një pyetje.

Atëherë, për ta qartësuar. Arsyeja kryesore e refuzimit është afati i gjatë i komandimit?

*(Anëtarë të Komisionit përgjigjen "Po!")*

Pra arsyeja e refuzimit për t'u komanduar si këshilltar është koha e gjatë e

komandimit?

**Maksim Qoku:** Kundër. Kundër çuarjes. Pro propozimit.

**Brunilda Kadi:** Pro propozimit.

**Dritan Hallunaj:** Pro propozimit.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro propozimit.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi që kërkesën e magjistrates {...} për dhënie pëlqimi... Të refuzojë kërkesën e magjistrates {...} për dhënie pëlqimi për komandimin e saj si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.

Kalojmë tek propozimi i dytë i ardhur nga ana e Komisionit lidhur me kthimin e zonjës {...}, ku Komisioni i propozon zonjës {...} tre pozicione, ku përfshihet Gjykata e Rrethit...

*(Fjala ndërpritet nga anëtarët.)*

**Illir Toska:** Relatori e ka sjellë propozimin e vet dhe të gjithë materialet e çështjes që në muajin korrik. Në atë moment, relatori ka konsideruar ato rrethana që ishin në atë moment kohor. Sot relatori bëri një propozim të ri. Konsideroi rrethanën e re dhe tha, meqenëse në Kavajë ka pozicion të lirë dhe zonja {...} ka qenë në pozicionin e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, zonja {...} të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Ky ishte propozimi i sotëm i relatorit.

**Alban Toro:** Edhe propozimi i mëparshëm, ta bëj për qartësi, konsistonte në: Të vendosë kthimin e zonjës {...} në pozicionin e mëparshëm si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe pastaj vazhdonte muhabeti i pamundësisë së kthimit.

**Brunilda Kadi:** Pra propozimi tani është për në Kavajë.

**Alban Toro:** Kavajë. Meqenëse aty e ka pasur dekretin e parë kur është emëruar.

**Naureda Llagami:** Atëherë, po zoti Toska!

**Ilir Toska:** Atëherë, unë kam një mendim ndryshe sa i përket kthimit në pozicion. Zonja {...} gëzon të drejtën nga ligji për t'u kthyer në pozicionin që mbante. Referuar rrethanave të përshkruara nga relatori, pozicioni i zonjës {...} është suprimuar me Dekret të Presidentit të Republikës. Marrë shkas nga kjo rrethanë, vlerësoj që do duhet të zbatohet neni 60 të ligjit të Statusit, t'i propozojmë zonjës {...} vendet vakante që kemi dhe të ketë të drejtën e zgjedhjes së njërit prej tyre. Ne do duhet t'i ofrojmë të gjitha pozicionet që janë... në fakt neni 60 thotë hap pas hapi tre pozicione. Për sa kohë ne i kemi të hapura pozicionet, mund t'i kërkojmë zonjës {...} të zgjedhë njëren prej tyre. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Po, zonja Kadi!

**Brunilda Kadi:** Kam një pyetje.

Si dilni në konkluzionin që me Dekretin e Presidentit është suprimuar pikërisht vendi i zonjës {...}?

**Ilir Toska:** Në konkluzionin se në momentin që ka dalë Dekreti kanë qenë 4 gjyqtarë në detyrë, zonja {...} ka qenë e komanduar dhe ka konsideruar në atë rast Presidenti i Republikës që të gjitha pozicionet mbi atë numër 4, janë të suprimuar.

Ky është vlerësimi im. Faleminderit!

**Brunilda Kadi:** Okej!

Mund të na jepet informacioni, në momentin e Dekretit të Presidentit në 2012-ën, si ka qenë gjendja e Gjykatës së Kavajës? Kush ka qenë në detyrë në atë moment?

**Ilir Toska:** Është e përshkruar.

**Brunilda Kadi:** Po mirë pra, nga dokumentat.

Jo! Nuk është e përshkruar. E lexova. Se nuk e kam lexuar tani.

**Ilir Toska:** Është thënë në relacion edhe kush kanë qenë gjyqtarët në pozicion në atë moment.

**Brunilda Kadi:** Jo, nuk është thënë.

Mund ta lexoni! Nuk është thënë.

Thuhet në përgjithësi.

**Ilir Toska:** Është me emra gjyqtarësh. Nuk është në përgjithësi.

**Brunilda Kadi:** Relacioni që kam unë, nuk e ka.

Zoti {...} në këtë kohë, kur ka dalë Dekreti i Presidentit, ku ka qenë? Sepse di që ka qenë disa herë i komanduar, në këtë kohë e keni verifikuar se mos është suprimuar për shembull vendi i zotit {...}?

Se në qoftë se kanë qenë të dy të komanduar, si dolët në konkluzionin që është suprimuar vendi i zonjës {...} dhe jo i zotit {...}? Verifikojeni pak të lutem! Në këtë kohë, zoti {...} ka qenë gjyqtar apo ka qenë i komanduar?

**Alban Toro:** Ka qenë i komanduar pranë Gjykatës së Lartë.

**Brunilda Kadi:** Atëherë, si dilni në konkluzionin, meqë e kishit lexuar relacionin njëlloj? Kushdo pra që e mori përsipër ta sqaronte, si dolët në konkluzionin që është suprimuar pikërisht vendi i zonjës {...} dhe jo i zotit {...}, meqenëse të dy ishin të komanduar?

**Ilir Toska:** E lexoj në mënyrën si e lexoj unë. Ju, nëse dilni në një konkluzion tjetër, jeni e ftuar ta bëni dhe mos kërkoni të tjerëve që hajde më thuaj një çik këtë, se nuk jeni zyshë (*mësuese*) e klasës këtu.

**Brunilda Kadi:** Unë thjesht bëj pyetjen për ata që e kanë kuptuar, se s'e sqaruan.

Okej! Pra doli...

Mirë pra, herën e parë kur u bë pyetja, thatë që vendet ishin të plota dhe e vetmja që s' ishte aty, ishte e komanduar, ishte zonja {...}.

Na doli një fakt tjetër, që s'e thatë. Pra që edhe zoti {...} ka qenë i komanduar në atë kohë.

**Brikena Ukperaj:** Në fakt zoti {...} mbas asaj kohe është kthyer në Gjykatën e Kavajës dhe...

**Brunilda Kadi:** Jo, nuk është kthyer asnjëherë.

**Brikena Ukperaj:** ...dhe ka marrë një komandim të dytë.

**Brunilda Kadi:** Mund ta thoni një çik datën?

Përsëri, edhe sikur të jetë kthyer, si dolët në konkluzionin që në datën e dekretit u suprimua pikërisht vendi i zonjës {...} dhe jo i zotit {...}. Kjo ishte pyetja.

**Brikena Ukperaj:** Po sepse fakti që ai është kthyer në atë pozicion, domethënë vet Këshilli kur e ka kthyer në Kavajë, ka vlerësuar që është pozicioni i tij. Unë nuk di se çka menduar Këshilli në atë kohë, por fakti që ka vendosur që ky do kthehet në këtë pozicion dhe nuk është zonja {...} apo s'e ke sistemuar në një pozicion tjetër, mendoj që do të ishte kjo.

**Brunilda Kadi:** Mendoj që duhet t'i shikoni dokumentat përpara se të flasim. Duhet ta shikojmë të saktë. Në cilën kohë ka qenë i komanduar sepse me sa kujtoj unë, meqenëse kam qenë edhe tek Këshilli i vjetër, zoti {...} nuk ka shkuar asnjë ditë në gjykatë. Ka përsëritur, sepse ka qenë me legjislacionin e vjetër.

Po verifikojeni pastaj! Mos flisni!

Verifikojeni!

**Ilir Toska:** Nëse ju thoni që është kështu, pse nuk e sillni?

**Brunilda Kadi:** Unë mendoj që është detyrë e relatorit dhe Komisionit të sjellë letrat. Mua nga relacioni më del që edhe zoti {...} është i komanduar. Thoni pastaj që në këtë kohë ai ka qenë në gjykatë.

**Naureda Llagami:** Atëherë, ndërkohë po bëhet verifikimi nga ana e stafit.

**Ilir Toska:** Këshilli ka komanduar zotin {...} në datë 4 qershor 2013 me vendimin nr. 338, pra në vitin 2012 ka qenë në gjykatë zoti {...}.

**Brunilda Kadi:** Ka edhe një komandim tjetër ai.

(Ndërkohë nga administrata e Këshillit verifikohet dosja e zotit {...}.)

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në diskutimin lidhur me... Kemi dy propozime, propozimin e relatorit dhe propozimin e zotit Toska.

Po, zonja Ukperaj!

**Brunilda Kadi:** Meqenëse nga ana e administratës u soll pjesa dokumentare në lidhje me statusin e gjyqtarit {...}, rezultoi që në 2016-ën ai është rikthyer në Gjykatën e Kavajës dhe është kthyer. Po! Kjo ishte për të sqaruar faktin që kush ka qenë në gjykatë në kohën X që po diskutohet. Tani, ka vlerë apo nuk ka vlerë diskutimi, propozimi i zotit

Toska, qëndron apo s'qëndron, ky është një diskutim tjetër. Kjo ishte thjesht për të sqaruar faktin.

**Naureda Llagami:** Po, zonja Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, së pari unë vlerësoj që në momentin e ndryshimit të numrit të gjyqtarëve dhe të strukturave administrative të gjykatave, sepse kam qenë edhe pjesë e Gjykatës së Lushnjës në atë kohë kur ndodhi ky ndryshim, zonja {...} ka qenë një pozicion të komanduar. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Kavajës u ngushtua në 4 gjyqtarë. Në momentin që zoti {...} është kthyer në gjykatë, vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka konsideruar që pozicioni vakant, ndërkohë që ishin dy gjyqtarë të komanduar, ka qenë pikërisht pozicioni i zotit {...}. Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit për Statusin, zonja {...} ka patur përsëri pozicion të suprimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe kjo gjë ka vazhduar deri në momentin kur asaj i ka mbaruar komandimi, pavarësisht shkakut të komandimit. Në momentin kur i ka mbaruar komandimi dhe është drejtuar Këshillit, në fuqi ka qenë neni 44 i ligjit për Statusin, që parashikon transferim pa pëlqim të magjistratit kur, sipas nenit 44/1/b, kur pozicioni i magjistratit suprimohet për shkak të ndryshimeve në strukturën organizative të gjykatave.

Në vlerësimin tim, vendi i lirë që është hapur sot në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, nuk është pozicioni i mëparshëm i magjistratit, që ai të kthehet në atë pozicion, por është një vend i ri, në të cilin, nëse magjistratin do ta çonim pa pëlqim, do ta kthenim në një transferim të detyruar. Prandaj, në vlerësimin tim, rikthimi automatikisht i zonjës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë nuk është në përputhje me dispozitat e ligjit për Statusin.

Çfarë thotë neni 44? Neni 44, në pikën 2 thotë që, nëse magjistratit i është suprimuar pozicioni, sipas shkronjës /b/ - pra kur ndryshon struktura administrative e gjykatave, ai ka të drejtë, ai mund të sistemohet në bazë të dy opsioneve. Së pari, nëse kemi suprimim të gjykatës, do shkojë në strukturën e re që përthith kompetencën e saj tokësore dhe, nëse nuk ndodh kjo, ai gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion të lirë, që është i lirë apo pritët të bëhet i lirë brenda 6 muajve nga momenti i shkurtimit të pozicionit (neni 44).

Unë jam dakord me propozimin që bën Iliri, por Iliri e trajton në kuadër të nenit 60. Unë e trajtoj në kuadër të nenit 44, duke marrë parasysh edhe mënyrën se si operuam me Gjykatën e Posaçme të transferimit të gjyqtarëve. Prandaj vlerësoj që sot, transferimi në Kavajë nuk mund të bëhet automatikisht për zonjën {...}, por zonjës {...} duhet t'i jepet e drejta të zgjedhë në të gjithë vendet vakante që në kemi në gjykatat e shkallës së parë, që janë gjykatat e të njëjtit nivel të juridiksionit të përgjithshëm me atë të zonjës {...}. Ky është edhe propozimi im.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim? Kalojmë në propozim variantin e dhënë nga...

**Brunilda Kadi:** Një sekondë se kam unë një diskutim.

Atëherë, nëse do shkohet me propozimin që bën zoti Toska, unë mendoj që në bazë të të dyja dispozitave që cituan kolegët, nuk mund t'i afrohen të gjitha pozicionet e lira që janë hapur, por duhet t'i afrohen 3 pozicionet e para që janë hapur të lira. Dhe për këtë duhet të verifikohet.

**Brikena Ukperaj:** 44-a nuk e thotë. Kjo është sipas 60-ës që po thua ti.

**Brunilda Kadi:** Tani, këtë diskutim e kemi bërë edhe për gjyqtarët e pezulluar të Gjykatës së Krimeve të Rënda (ish).

**Brikena Ukperaj:** Propozimi im ishte sipas nenit 44 dhe jo nenit 60. Neni 44.

Unë mendoj që kërkesa e zonjës {...} ose sistemimi i zonjës {...} duhet të trajtohet sipas nenit 44, duke i dhënë asaj mundësinë të zgjedhë në të gjitha pozicionet e lira që kemi në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

**Brunilda Kadi:** Thjesht, dispozita që referoni juve e ka edhe këtë kuptim. Pra asaj i afrohen 3 pozicione që është apo pritet të bëhet Brikena.

**Brikena Ukperaj:** Jo! Nuk e ka. Sepse .. 60 ka që ti i ofron 1 pozicion. 60-ta nuk ka lidhje me ndryshimin e strukturës administrative të gjykatës. 60-ta ka lidhje kur për shkaqe nga më të ndryshme ai pozicion nuk është i lirë. Nuk ka lidhje me ndryshimin e strukturës së gjykatës. 60-ta do të thotë që ti mund t'i ofrosh 1, pastaj një tjetër, pastaj e çon me detyrim.

Unë e trajtoj sipas 44-ës, në kuptimin që sot duhet t'i jepen të gjitha pozicionet e

lira, që të zgjedhë.

**Marçela Shehu:** Kam një pyetje për të sqaruar për 44-ën, për nenin 44.

Ju thoni, që në referim të kësaj dispozite, duke qenë se vendi i zonjës {...} është suprimuar për shkak të suprimimit të pozicionit të saj, atëherë ajo duhet të trajtohet sipas pikës 2 të nenit 44, germa /b/ “të gëzojë të drejtën të zgjedhë për t’u transferuar”.

Duke qenë se vendi që ka pasur përpara suprimimit të pozicionit të zonjës {...}, tashmë është i lirë, pra pozicioni në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë është i lirë, a mendoni ju që ka shkelje ligjore nëse propozohet kthimi i zonjës {...} apo transferimi i saj në këtë gjykatë?

**Brikena Ukperaj:** Edhe një herë. Në qoftë se ky pozicion do të ishte pozicioni i zonjës {...} dhe i ruajtur, automatikisht do shkonte aty sepse në përfundim të periudhës së komandimit, ajo do të kthehet në vendin e mëparshëm kur pozicioni është i lirë. Kur vetë organi që ka detyrim për të administruar sistemin e ka suprimuar dhe sot ai është një vend i lirë, ai vend mund të përfshihet në listën e të gjithë vendeve të tjera të lira që ajo ka të drejtë të zgjedhë. Për mua, unë vlerësoj që ajo duhet të zgjedhë në këtë moment për t’u transferuar në një gjyqtarë tjetër. Të paktën kështu e interpretoj ligjin.

**Marçela Shehu:** Domethënë, gëzon të drejtën të zgjedhë, nënkupton të drejtën e saj të zgjedhjes në më shumë se një gjykatë. Pra ne duhet t’i japim disa alternativa zonjës {...}, ku mund të përfshihet edhe Kavaja dhe zonja {...} të zgjedhë.

**Naureda Llagami:** Atëherë, a kalojmë në votim propozimin e relatorit dhe më pas propozimet e tjera?

Atëherë, ndryshimi fillon me Ilirin.

**Ilir Toska:** Propozimi im dhe i Brikenës është i njëjtë.

Ne kishim ndryshim vetëm bazën ligjore.

Unë thashë të gjitha. Por thjesht është referenca ligjore e ndryshme.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në votim propozimin e bërë nga Iliri dhe Brikena, për sa i përket opsionit.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Do t’i marrim me radhë... Ndajeni!



**Ilir Toska:** Propozimin unë e bëra me zë dhe thashë, t'i propozohen të gjithë gjykatat që kanë vende vakante në këtë moment. Ky ishte.

Unë thashë arsyetimin tim referuar nenit 60. Ndërsa Brikena tha neni 44.

Në finale nuk ndryshon thelbi i propozimit.

Atëherë, unë bie dakord edhe me dispozitën që konsideron Brikena. Nuk është se bën diferencë thelbi i propozimit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, duke qenë që zoti Toska hoqi dorë nga shkak i ligjor i propozimit të tij.

Atëherë, kalojmë me propozimin e bërë nga zonja Ukperaj, së bashku me zotin Toska. Kalojmë në votim.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Jam kundër sepse mendoj që në bazë të nenit 44, pika b edhe nëse do zbatohet kjo, duhet të identifikohet cili vend vakant është bërë i pari në kohën kur gjyqtarja kishte të drejtë të zgjidheshe apo të ktheheshe. Dhe për këtë arsye unë jam kundër propozimit që të zgjedhë midis të gjitha vendeve të lira.

**Dritan Hallunaj:** Pro propozimit.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Duke qenë se Këshilli miratoi propozimin e zonjës Ukperaj dhe të zotit Toska, formulimi është në projektvendim që: Të vendosë që t'i propozojë zonjës {...} të gjithë...

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, propozimi ishte që...

Vendimi i parë që morëm ne ishte refuzimi i kërkesës për t'u komanduar në Gjykatë të Lartë dhe vendimi i dytë është që, vendosi që t'i njohë zonjës {...} të drejtën

për të zgjedhur një nga pozicionet vakante në të gjitha gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të cilat do t'i njoftohen nga Këshilli. Sepse unë sot në këtë moment nuk di të them se cilat janë gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm që kanë vende vakante.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, një kopje... miratimi i bërë i projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga relatori. 3. Një kopje e këtij vendimi do t'i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 23.01.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtarit {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 6. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Erion Fejzulla, USAID.*
- 10. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 12. Ama Kraja, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqarit {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqarit {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit”. Relatimi i kësaj

çështjeje do bëhet sërish nga zoti Alban Toro.

**Alban Toro:** Po, faleminderit!

Atëherë, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin 14, 10.02.2017, ka vendosur komandimin e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, {...}, si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë për një periudhë 3-vjeçare. Komandimi i këtij gjyqtari është bërë bazuar në ligjin 96/2016 mbështetur në nenet 53, 54, 56, në pikën 4 neni 160 sipas të cilit periudha prej 3 vitesh ishte periudha maksimale e komandimit. Si e tillë, kjo periudhë komandimi pranë Gjykatës së Lartë përfundon më datë 10.02.2020.

Rezulton se z. {...} është komanduar si këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë, Në këtë mënyrë ndihmësmagjistrati, {...}, ka punuar gjatë gjithë periudhës së parë në këtë gjykatë.

Në referim të nenit 56, pika 2 të ligjit nr. 96/2016, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, 3 muaj para mbarimit të mandatit të parë, ka paraqitur pranë Këshillit kërkesë me shkrim për konfirmimin e ndihmësmagjistratit, z. {...}, si i komanduar në Gjykatën e Lartë.

Kështu, me anë të shkresës nr. 5310 prot., datë 24.10.2019, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. 2552/1 prot., datë 23.10.2019, Gjykata e Lartë ka kërkuar konfirmimin për një periudhë 1-vjeçare të ndihmësmagjistratit {...}, si i komanduar në Gjykatën e Lartë. Në këtë shkresë, theksohet se në kushtet që aktualisht rezulton që Gjykata e Lartë ka vetëm 4 ndihmësmagjistratë të komanduar, ndërkohë që në referim të nenit 34, pika 4 të ligjit 98/2016, më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë të njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë duhet të përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë vlerëson të nevojshme që Këshilli i Lartë Gjyqësor të vendosë konfirmimin e z. {...} si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë, duke përsëritur komandimin e tij për një periudhë 1-vjeçare.

Gjithashtu rezulton që z. {...}, më datë 23.10.2019, ka dhënë pëlqimin për t’u konfirmuar si ndihmësmagjistrat, duke kërkuar përsëritjen e komandimit me një vit. Sipas

vlerësimit të gjyqtarit, eksperiencia e deritanishme pranë Gjykatës së Lartë, ka qenë e tillë që ka lejuar të kontribuojë në mbarëvajtjen e punës së autoritetit më të lartë gjyqësor dhe njëkohësisht e ka zhvilluar profesionalisht.

Më herët për trajtimin e një kërkesë të ngjashme të paraqitur në Këshill nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës me shkresën 3376/1 prot, datë 15.10.2019 i është kërkuar një informacion Gjykatës së Lartë lidhur me organizimin aktual të punës së ndihmësve ligjorë pranë Gjykatës së Lartë.

Në përgjigjen e ardhur nga Gjykata e Lartë, me shkresën 2495/1 prot datë 16.10.2019, ndër të tjera referohet se: “Në Gjykatën e Lartë ka gjithsej 4 ndihmësmagjistratë dhe 5 këshilltarë ligjorë që përbëjnë organikën efektive të ndihmësve ligjorë të Gjykatës së Lartë. Deri në vitin 2018, ndihmësit ligjorë ishin të caktuar dhe punonin pranë një gjyqtari të Gjykatës së Lartë. Për shkak të numrit të pakët të gjyqtarëve të mbetur dhe përgatitjeve për të ndërtuar Njësinë Ligjore të Gjykatës së Lartë, u mendua dhe u vendos që këshilltarët të riorganizoheshin dhe të ndaheshin sipas kolegjeve. Këshilltarët u ndanë në tre kolegje, sipas llojit të çështjeve për të cilat kryhej puna hulumtuese dhe përgatitore. Kështu, në Kolegjin Administrativ ushtrojnë detyrën: Florjan Kalaja, {...} dhe {...}; në Kolegjin Civil ushtrojnë detyrën: {...}, {...}, {...} dhe {...}; në Kolegjin Penal ushtrojnë detyrën: {...} dhe {...}”.

Dhe më tej ka vijuar citimi i shkresës së Gjykatës së Lartë.

Nga informacioni i administruar, në kohën e paraqitjes së kërkesës për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtarit {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit, Komisioni më datë 28.10.2019 me anë të komunikimit elektronik ka kërkuar informacion në lidhje me ngarkesën e gjykimeve pranë Gjykatës së Rrethit Fier (ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit) si dhe ngarkesën e gjykime që ka secili gjyqtar.

Nga zëvendëskryetarja e Gjykatës së Rrethit Fier rezultonte se ngarkesa për çështje të gjykuara vijon si më poshtë: Gjyqtari {...} 121 çështje; {...} 110 çështje; {...} 125 çështje; {...} 127 çështje; {...} 124 çështje; {...} 76 çështje; {...} 92 çështje; {...} 39 çështje; {...} 66 çështje; {...} 132 çështje; {...} 76 çështje.

Në nenin 34 të ligjit 98/2016, lidhur me organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë parashikohet se:

“1. Pranë Gjykatës së Lartë funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor.”

Më tej është vijuar, citohet dispozita ligjore përkatëse.

Ndërkohë në nenin 56 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me kushtet dhe kriteret e komandimit në Gjykatën e Lartë parashikohet se:

“1- Magjistrati mund të komandohet në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese dhe Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme me mandat pesëvjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje, me kërkesë të institucionit ku komandohet magjistrati.

2- Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ose i Gjykatës së Lartë, tre muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit të një ndihmësmagjistrati, mund t'i paraqesë Këshillit kërkesë me shkrim për konfirmimin e ndihmësmagjistratit si i komanduar në Gjykatën Kushtetuese ose Gjykatën e Lartë. Këshilli konfirmon ndihmësmagjistratin nëse është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në vlerësimin etik dhe profesional, si dhe nëse ndihmësmagjistrati ka dhënë pëlqimin për konfirmim.”

Propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës - Bazuar në rrethanat faktike të parashtruara dhe në referim të dispozitave ligjore të sipërcituara, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, vlerëson se kërkesa e paraqitur është në përputhje me përcaktimet e nenit 56 të ligjit nr.96/2016. Kështu në rastin konkret rezulton se ka një kërkesë të motivuar të paraqitur nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë për konfirmimin e ndihmësmagjistratit z. {...} në Gjykatën e Lartë, ku referohet dhe nevoja konkrete; kërkesa është paraqitur brenda afatit të përcaktuar nga ligji, tre muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit; dhe gjyqtari {...} ka dhënë pëlqimin e tij për konfirmim.

Lidhur me faktin se, në Gjykatën e Lartë, aktualisht ushtron funksionin e ndihmësmagjistratit, Komisioni vlerëson se në rastin konkret, në referim të pikës 6 të nenit 8 të ligjit 96/2016, ndryshuar me ligjin 48/2019, në kushtet kur, papajtueshmëria ambientale... Kjo ishte e hequr...

Në vlerësimin e bërë, Komisioni bazohet dhe në organizimin aktual të punës në Gjykatën e Lartë, siç u parashtrua më sipër, ku konstatohet që Gjykata e Lartë ka marrë të gjitha masat për shmangien e të gjitha situatave të papajtueshmërisë apo konfliktit të interesit ndërmjet ndihmësmagjistratëve që ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Lartë, me qëllim garantimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Të konfirmojë si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë gjyqtarin {...}, duke vendosur zgjatjen e mandatit të komandimit me një vit.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

**Brunilda Kadi:** Nga të dhënat që jepen nga relacioni dhe statistikak që kanë ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, ku dhe gjyqtari ushtron detyrën e tij të përhershme, rezulton që kjo gjykatë ka relativisht ngarkesë të lartë. Nga ana tjetër, situata e Gjykatës së Lartë, e dimë të gjithë, dimë që sot nuk ka asnjë gjyqtar, nuk bëhet asnjë gjykim në Gjykatën e Lartë dhe ideja ime është që ne duhet të bëjmë një balancë midis asaj që sjell dobi ndenjja/vazhdimi i komandimit të gjyqtarit në Gjykatën e Lartë me atë çfarë cenon tek gjykata ku ai vazhdon të mos gjykojë. Unë mendoj që duhet të ishte marrë një informacion nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë që çfarë pune reale bën magjistrati aty, për të bërë balancimin. Se në qoftë se s'ka gjyqtarë, nuk e di se çfarë është duke bërë. Dhe derisa të plotësohet gjykata me gjyqtarë, që të ketë nevojë, që punët e ndihmësit të jenë të dobishme dhe të vihen në lëvizje, nuk e di pse është e nevojshme. Dhe konkretisht të dinim çfarë bën ai dhe të gjithë ndihmësit e tjerë në fakt.

**Alban Toro:** Atëherë Brunilda, nuk e di, ke pasur mundësi ta dëgjosh kryetarin e Gjykatës së Lartë në detyrë, në takimin e fundit që patëm për një memorandum të përgatitur nga USAID-i me partnerët tanë ndërkombëtarë, ku ai tha që është krijuar një stok çështjesh 40 mijë çështjesh dhe të gjithë këta punonjësit... pra e kemi të pamjaftueshëm, sidomos në kategorinë e ndihmësmagjistratëve, numri i ndihmësmagjistratëve...

**Brunilda Kadi:** Më fal që të ndërpres. Stokun e dimë të gjithë. Se nuk na i thotë kryetari. Çfarë bën realisht? Çfarë po bën realisht?



**Alban Toro:** Më lejo ta mbaroj pra.

Do të ta sqaroj.

...dhe më tej ai të tha, aktualisht të gjithë ndihmësit ligjorë kanë mundur të evadojnë 3000 dosje, pra të përgatisin 3000 relacione. Që do të thotë, të gjithë këta ndihmës magjistratë që rezultojnë të jenë të pakët në numër, janë të detyruar të vazhdojnë të punojnë për të krijuar relacione të gatshëm për gjyqtarët që do të vijnë në Gjykatën e Lartë dhe t'iu japin të gatshëm produktin për çdo dosje të cilën është stok në atë gjykatë. Këtë do bëjnë ato. Këtë po vazhdojnë të bëjnë.

**Brunilda Kadi:** Po pra. Dhe ideja ishte, -se ishim bashkë në atë takim, -dhe 3000 dosje... ne nuk e dimë konkretisht, sa ndihmës i kanë bërë për çfarë kohe. Pra pyetja ime në thelb ishte: - Sa është rendimenti i magjistratit dhe sa vlerë ka puna e tij? Të vazhdojë të rrijë në Gjykatën e Lartë, me atë që është duke lënë pa bërë (në thonjëza, në kuptimin që s'e ushtron detyrën), në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila rezulton një gjykatë me ngarkesë relativisht të lartë. Kjo ishte pyetja. Se i gjithë informacioni nuk është e thënë të na e japë kryetari në detyrë i Gjykatës së Lartë, se ne e dimë zyrtarisht këtë edhe nga raportimet që bën vet Këshilli. Kjo ishte pyetja ime. Pra të krahasosh rendimentin e punës.

Megjithatë, në qoftë se ju e vlerësoni që është më mirë.

**Medi Bici:** Ndihmësit ligjorë në Gjykatën e Lartë sot kanë detyrimin që të bëjnë 22 çështje, të përgatisin 22 çështje në muaj. Ky është detyrimi dhe këtë detyrim e përmbushin, përveç detyrimeve të tjera.

**Naureda Llagami:** Kemi propozim konkret nga ana jote?

Jo!

Atëherë, kalojmë me propozimin e Komisionit?

Maksi!

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

*(Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet.)*

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Konfirmimin si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të gjyqtarit {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit.

Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit {...}, Gjykatës së Lartë si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 23.01.2020)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 6. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Erion Fejzulla, USAID.*
- 10. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 12. Ama Kraja, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e radhës së rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, {...}” dhe relatimi i këtij projekt-akti do të bëhet

sërish nga zoti Alban Toro.

**Alban Toro:** Atëherë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 9.01.2020, është depozituar një kërkesë me shkrim nga gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}, nëpërmjet të cilës ajo ka parashtruar dorëheqjen e saj nga statusi i magjistratit. Kjo e fundi me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.13, datë 24.11.1993, ka filluar karrierën e magjistratit duke u emëruar si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Me vendimin nr. 1, datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë znj. {...} ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, është emëruar gjyqtare po në këtë gjykatë.

Me vendimin nr. 260, datë 01.04.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë znj. {...} është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Me vendimin nr. 419, datë 20.12.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë znj. {...} është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku dhe aktualisht ushtron funksionin e magjistratit.

Në kërkesën e saj, gjyqtarja znj. {...} ka kërkuar që: "...mbarimi i mandatit të realizohet edhe përpara afatit të parashikuar nga neni 65/2 të ligjit nr.96/2016..". Në rastin konkret, dorëheqja e znj. {...} është kërkuar në mbështetje të pikës 3, të nenit 65, të Ligjit të Statusit.

Më konkretisht në 10.01.2020 është depozituar kërkesa nr. 98/1 prot. nga gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}, nëpërmjet të cilës ajo kërkon që kërkesa e datës 09.01.2020 të shqyrtohet në një kohë më të shkurtër duke ju referuar nenit 65/3 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

Si motiv të dorëheqjes znj. {...} ka parashtruar mbushjen e moshës së detyruar të pension të pleqërisë si dhe ka paraqitur dokumentet justifikues të aplikimit pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

Për rrjedhojë, znj. {...} i ka kërkuar Këshillit miratimin e dorëheqjes dhe dhënien efekt të saj në një kohë më të shkurtër e mbështetur këtë kërkim në dokumentet

justifikues të sipërcituar.

Sipas nenit 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni”.

Nga informacioni i administruar, në kohën e paraqitjes së kërkesës së përshpejtuar të dorëheqjes nga magjistarja, nga kancelaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezultonte se ngarkesa për çështje të gjykuara ka qenë për {...} 139 çështje.

Instituti i dorëheqjes është një akt vullnetar dhe nuk mund të jetë i kufizuar në kohë. Ai bazohet në vullnetin e lirë të magjistratit për të ndërprerë në çdo kohë vijimin e detyrës dhe për rrjedhim kontrata e shërbimit publik për këtë shkak përfundon. Magjistrati me shkresë të depozituar në Zyrën e Protokollit ka shprehur dëshirën për t’u dorëhequr duke qartësuar dhe siguruar vullnetin përpara Institucionit si edhe ka kërkuar deklarimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes.

Ndërkohë kur dorëheqja, sipas nenit 65 të ligjit të sipërcituar, jep efekte në fund të muajit pasardhës nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes, domethënë më datë 31.01.2020.

Për rrjedhojë, znj. {...} i ka kërkuar Këshillit miratimin e dorëheqjes dhe dhënien efekt të saj përpara datës 24.01.2020.

Nga sa më sipër, rezulton që në rastin konkret të plotësohen kërkesat e ligjit për miratimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të dorëheqjes së gjyqtarës znj. {...}, duke i dhënë asaj efekte përpara kohës së përcaktuar nga ligji, pika 2, e nenit 65, të ligjit të Statusit.

Së pari, pranë Këshillit është depozituar me shkrim kërkesa për heqjen dorë nga

statusi i magistratit; kjo kërkesë është e motivuar, pra gjyqtari në fjalë ka parashtruar një motiv për dorëheqjen e tij, motiv ky që, përveçse personal, nuk mund të vlerësohet si i pajustificuar; Së treti, dhënia e efekte të dorëheqjes përpara kohës së përcaktuar nga ligji, nuk cenon interesin publik në kuptimin e krijimit të ndonjë situatë negative të pakthyeshme për dhënien e drejtësisë, e cila në çdo rast duhet të mbahet në vëmendjen e Këshillit, si organi përgjegjës për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Sa i përket kohës kur dorëheqja e gjyqtarës znj. {...} duhet të japë efektet, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të duhet të konsiderojë kërkesën e gjyqtarës nga njëra anë, por edhe lënien e një kohe të mjaftueshme brenda të cilës gjyqtarja mund të përfundojë gjykimin e atyre çështjeve që mund të jenë në fazën e fundit, por edhe për dorëzimin e detyrës nga ajo. Nga vlerësimi mbi këto kritere, data 24.01.2020 duket që konsideron të dyja ato.

Pra propozimi që i parashtrohet Këshillit të Lartë Gjyqësor është: Deklarimi i mbarimit të statusit të magistratit për znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 24.01.2020. Të përjashtojë gjyqtarën znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kemi diskutime lidhur me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni?

Po, zonja Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, marrë shkas të flas sepse qëndrimi që Këshilli do mbajë në këtë rast është shumë i rëndësishëm për të gjitha dorëheqjet që gjyqtarët, pa mbushur moshën 67 vjeç, do t'i paraqesin Këshillit me motivimin që duan të dalin në pension.

Unë e kam thënë edhe herë tjetër që gjyqtari mund të japë dorëheqjen në çdo kohë dhe nuk është e nevojshme të njoftojë edhe shkakun dhe dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës nga deklarimi i saj, me përjashtim të këtij parashikimi, me kërkesë të

motivuar të gjyqtarit, mund të deklarohet edhe mbarimi i statusit para kësaj kohe.

Në vlerësimin tim, kërkesa e gjyqtares që “unë heq dorë nga statusi se dua të dal në pension 65 vjeç”, nuk përbën kërkesë të motivuar për mbarim të statusit para afatit. Gjyqtari ka disa të drejta për shkak të statusit, por ka edhe disa detyrime që lidhen me statusin e tij. Derisa dorëheqja të japë efekte, gjyqtari ka statusin e magjistratit dhe në vlerësimin tim, pavarësisht se në nenin 64, me ndryshimet, nuk parashikohet që mbush moshën e pensionit 67 vjeç, moshja 67 vjeç është moshë e pensionit për gjyqtarin. Me mbarimin e statusit para afatit dhe nëse gjyqtari nuk e ka mbushur moshën 67 vjeç por është 66, ai mund të aplikojë, pastaj është e drejtë e tij për të aplikuar si çdo individ tjetër që ka arritur moshën e pensionit. Por për sa kohë e gëzon statusin e gjyqtarit, nuk mund të përbëjë kërkesë të motivuar deklarimi i mbarimit sepse unë dua të dal në pension 65 vjeç, se është në kundërshtim edhe me parashikimet (në vlerësimin tim) të ligjit për Statusin dhe për parashikimet që vet Statusi lidhet me pensionin e parakohshëm.

Prandaj mendoj që kërkesa e zonjës {...} duhet të trajtohet si një mbarim normal i statusit të magjistratit, duke i dhënë efektet e saj në 29.02.2020. Pra, propozoj që të ndryshojë pika 2. Efektet e këtij urdhërimi të fillojnë në datën 29.02.2020, duke e trajtuar si një kërkesë normale që bëhet për dorëheqje.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

**Maksim Qoku:** Për të shtuar vetëm diçka mbi atë çka tha Brikena.

Sepse kemi një konfondim në aspektin e nenit 64, midis pikas /a/ “jep dorëheqjen” dhe pikës /c/ “mbush moshën e pensionit”.

Tani ne, fakti që jemi në situatën që baza ligjore është në fuqi dhe moshja e magjistratit është 67 vjeç, atëherë jemi në kushtet e kërimit të dorëheqjes, të pikës /a/ të nenit 64. Për pasojë, për efekt orientimi dhe relacioni këtu duhet, midis çmuarjes së faktit të ekzistencës së motivit si shkak të motivuar apo jo. Por jemi tek dorëheqja.

Pra mos të përmendet më aspekti i pensionit që mos të konfondohemi më në aspektin e pikës /a/.

...si shkak. Okej. Se relacioni erdhi... Atëherë, nëse jemi këtu, pastaj jam për pjesën e arsytimit të Brikenës që ne nuk jemi në kushtet e 64/2, më fal 65/2-shit, 3-shit,



por jemi tek kushtet e 2-shit që duhet të vijë një dorëheqje normale në afatin e përcaktuar nga ligji.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Kam përshtypjen që Këshilli nuk mund të vendosë se kush del në pension pleqërie apo kush nuk del në pension pleqërie. Ligji ka përcaktuar moshën e mbarimit të statusit të magjistratit, që është 67 vjeç.

Nëse një gjyqtar sipas ligjit bazë gëzon të drejtën e pensionit të pleqërisë, kjo është një e drejtë që ia ka njohur ligji. Përtej moshës 65 vjeç, ai përsëri gëzon të drejtën të qëndrojë në detyrë nëse nuk do që të dalë në pension pleqërie. E drejta e pensionit të pleqërisë është e drejtë kushtetuese. Nuk mund të pengojmë asnjë gjyqtar që të lërë punën në sistem dhe të zgjedhë të përfitojë nga e drejta e tij kushtetuese e pensionit të pleqërisë. Nuk e di me çfarë atributi Këshilli do t'i thotë që gjyqtari del në pension 67 vjeç. Në fakt ligji ka përcaktuar që statusi mbaron 67 vjeç. Të drejtat e tij për të ushtruar funksionin e gjyqtarit, mbarojnë në këtë moshë. Përtej saj, e pengon ligji. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

**Brikena Ukperaj:** Për të sqaruar edhe një herë atë që thashë.

Sigurisht gjyqtari mund të zgjedhë të dalë në pension ose 65 ose 67, por po që gjyqtar, do dalë 67. Kur t'i mbarojë statusi si gjyqtar, mund të dalë edhe 65. Por kjo nuk mund të përbëjë shkak dhe nuk mund të quhet kërkesë e motivuar për t'ia trajtuar dorëheqjen para afatit. Këtë thashë.

**Ilir Toska:** Ajo që unë po thosha është: e drejta e pensionit është e drejtë kushtetuese. Nëse kjo nuk është një motiv, unë nuk e di se çfarë motivi tjetër duhet të paraqesë një gjyqtar që të thotë që kam një të drejtë kushtetuese dhe dua të iki që sot nga sistemi.

**Brunilda Kadi:** Edhe unë, se pak a shumë diskutimet e zotit Toska dhe zonjës Ukperaj janë deri diku të përbashkëta. Diskutimi me sa kuptoj unë, i zonjës Ukperaj, është që, a është një motiv e drejta, se, që të gjithë biem dakord që ka të drejtë të dalë në pension më përpara dhe këtë s'e pengon dot. Mosha 67 është kufiri maksimal, që edhe po

të dojë të vazhdojë, ti si Këshill ia deklaroi mbarimin e statusit. Për shkak të moshës. Ndërkohë, ka të drejtë ta ushtrojë.

Problemi është që ajo tek kërkesa thotë që unë me ndërgjegje deklaroj që s'vazhdoj dot më të gjykoj. Pra për mua tani diskutimi është: -A është ky një motiv sipas 65, pikës 3, kur vet gjyqtari deklaroi që unë jam tani në një pikë që s'vazhdoj dot më të gjykoj dhe po largohem edhe për këtë arsye. Unë mendoj që ky është një motiv, është një deklaram i saj, është subjektive, dhe unë nuk e di a ka Këshilli diskrecion të diskutojë këtë pjesë, kur vet magjistrati deklaroi që unë nuk gjykoj dot më dhe e dua tani dorëheqjen, dhe motivi është që kam arritur atë moshë që nuk gjykoj dot më. Mendoj që, domethënë po e deklaroj votën time, jam pro pranimit të dorëheqjes sipas nenit 65, pika 3.

**Brikena Ukperaj:** Në vlerësimin tim, qenia magjistrat ka të drejta dhe ka detyrime dhe gjyqtari s'mund të thotë që unë nuk dua të, nuk përbën kërkesë të motivuar sepse kjo ka të bëjë me interesin publik, me cenimin e funksionalitetit të gjykatës dhe pastaj duhen kanalizuar në kanale të tjera.

Unë nuk them që gjyqtarja nuk ka të drejtë të japë dorëheqjen, por nuk është dorëheqje me efekt të menjëhershëm. Është dorëheqje në fund të muajit pasardhës.

**Maksim Qoku:** Ne po debatojmë për motivin.

Nuk na duket motiv sepse ne e dimë shumë mirë, kemi qenë në pjesën e grupit të ndryshimit të ligjeve për punën e moshës dhe në aspektin relatues të kësaj, nga ligjvënësi është marrë parasysh pasja e moshës, dhe kjo moshë lidhet me gjyqin e shkakut. Pastaj, për të tjerat ne, paradoksalisht për një muaj po zihemi.

**Naureda Llagami:** Atëherë, diskutimi është: Keni propozim konkret nga ana juaj?

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

Po kemi propozim pra.

Atëherë, siç kemi vepruar për të gjithë, do kalojmë fillimisht propozimin... Kalojmë me propozimin për ndryshimin e pikës 2 nga ana...

*(Disa nga anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)*

Të lutem edhe një herë, të bëjmë riformulin Bruna, se nuk arrijmë dot ta bëjmë duke folur të gjithë përnjëherë.

Dakord.

Fillojmë me hedhjen e propozimit të Komisionit në votim.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistrates për znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së saj nga ky status.

Efektet e urdhërimit fillojnë më datë 24.01.2020.

Përfundimin e menjëhershëm të gjyqtares {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 23.01.2020)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 6. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 7. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 8. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 9. Erion Fejzulla, USAID.**
- 10. Gregor Borkowski, EURALIUS.**
- 12. Ama Kraja, OSCE.**

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, Nëpunës Përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit profesional dhe etik pranë Këshillit të Lartë

Gjyqësor. Relatimi i këtij projekt-akti do të bëhet nga zoti Ilir Toska.

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Atëherë, zoti {...}, më datë 8 janar të vitit 2020 ka paraqitur një kërkesë me të cilën ka kërkuar dorëheqjen nga statusi i magjistratit. Më tej ka kërkuar po ashtu që dorëheqja e tij të trajtohet me përparësi duke paraqitur si motiv moshën dhe faktin që do të përfitojë nga e drejta e pensionit të pleqërisë dhe mbi këtë bazë është përgatitur edhe projektvendimi, sipas të cilit Këshillit i propozohet të vendosë deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të dorëheqjes së motivuar nga ky status. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 15.02.2020.

Në këtë rast është pasur në konsideratë ajo që zoti {...} ka referuar në kërkesën e tij, që kërkon që statusi të vazhdojë deri në këtë datë.

Po kështu, është patur parasysh edhe situata pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me ngarkesën e punës të zotit {...}, i cili ka në proces vlerësimi disa dosje për disa gjyqtarë dhe është konsideruar që të përfundojë ato që ka në fazën e fundit të përpilimit të projektvlerësimit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Kemi më diskutim lidhur me propozimin?

Nëse jo, kalojmë në votim.

**Maksim Qoku:** Kundër. Për të njëjtat standarde që kam parashtruar gjithmonë në këto raste.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Kundër. Për të njëjtin arsyetim që bëra më parë. Duhet trajtuar

si dorëheqje normale.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të dorëheqjes së motivuar të tij nga ky status.

Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 15.02.2020.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 23.01.2020)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Durrës, z. {...}” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

**11. Marçela Shehu**

**(anëtare)**

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 6. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 7. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 8. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 9. Erion Fejzulla, USAID.**
- 10. Gregor Borkowski, EURALIUS.**
- 12. Ama Kraja, OSCE.**

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Durrës, z. {...}” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në çështjen e radhës të rendit të ditës.

**Erjon Muharremaj:** A mund të bëj një propozim të lutem?

**Naureda Llagami:** Po, zoti Muharremaj!

**Erjon Muharremaj:** Meqë kanë mbetur ende pa u shqyrtuar edhe 7 pika të tjera të

rendi të ditës, a ka mundësi të bëjmë një pushim 5 minuta, për t'u rikthyer pas pushimit?

**Naureda Llagami:** Po! Dakord!

*(Anëtarët e Këshillit bëjnë 10 minuta pushim për të rifilluar më pas më mbledhjen.)*

Për t'u rikthyer në mbledhje. Kalojmë me pikën e 7-të të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Durrës, z. {...}”. Relator i këtij projekt-akti është zoti Alban Toro.

**Alban Toro:** Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 30.12.2019, është depozituar një kërkesë me shkrim (protokolluar me nr.6503 prot.) nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, z. {...}, nëpërmjet të cilës ai ka parashtruar dorëheqjen e tij nga statusi i magjistratit. Ky i fundi me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 4, 10.11.1997, ka filluar karrierën e magjistratit duke u emëruar si ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Me dekret 3925, 31.07.2003 të Presidentit të Republikës, z. {...} ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër.

Me vendimin 263, datë 07.05.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë z. {...} është transferuar në Gjykatën e Apelit Durrës ku ka ushtruar funksionin e magjistratit.

Me vendimin nr. 24, datë 09.02.2018 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për z. {...} është marrë vendim pezullimi nga detyra e gjyqtarit për shkak të marrjes si i pandehur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime e Renda.

Në kërkesën e tij, gjyqtari z. {...} ka kërkuar që: “ .. mbarimi i mandatit të realizohet në parashikim nga neni 65/1 të ligjit 96/2016, “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës..”.

Si motiv të dorëheqjes z. {...} ka parashtruar faktin se prej dy vitesh është i pezulluar për shkak të procedimit penal kundrejt tij, si dhe statusi i “gjyqtarit” që ai ka për afro 23 vitesh kushtëzon negativisht konkluzionin objektiv për çështjen penale, në

mungesë të këtij statusi, gjyqtari vlerëson që çështja penale do të shqyrtohet me objektivitetin e duhur për fazën në të cilin ndodhet. Gjithashtu gjyqtari z. {...} shprehet se “..kjo dorëheqje nuk ka asnjë lidhje me procesin e vlerësimit sipas ligjit 94/2016 pasi nuk jam në dijeni se kjo procedurë nga filluar nga KPK-ja (të paktën nuk është komunikuar asnjë njoftim fillestar nga kjo e fundit, -pretendon ai).” Nga verifikimi i bërë nga komisioni në faqen zyrtare të KPK, rezulton të jetë publikuar njoftimi lidhur me shortin e zhvilluar më 12.11.2019 dhe referuar listës rezulton se z. {...} bën pjesë në këtë listë, renditur në pikën 45 të saj.

I jemi referuar nenit 65 i cili trajton dorëheqjen në fjalë. Arsytimi i relatorit dhe i Komisionit njëkohësisht në këtë aspekt është i njëjtë me arsyetimet e mëparshme në rastet e dorëheqjeve, por elementet që janë për t’u vënë në vëmendjen tuaj, janë pikërisht këto si vijojnë:

Nga informacioni i administruar, në kohën e paraqitjes së kërkesës për dorëheqje nga magjistrati, më datë 17.1.2020 nga kancelari i Gjykatës së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime e Renda rezultonte se për gjyqtarin z. {...} është marrë vendim nr. 79 akti më datë 29.10.2019, ku në pikën 2.1 të vendimit është vendosur: “Deklarimin e tij fajtor për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë të kryer në bashkëpunim të parashikuar nga neni 319/ç e 25 Kodit Penal ku dënimi i tij bëhet në bazë të kësaj dispozite me 3 vite burgim. Në pikën 2.2 në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimi përfundimtare për të pandehurin {...} është 2 vite burgim. Në pikën 2.3 të vendimit, në mbështetje të nenit 30/1, 35/1, 44/2 të Kodit Penal, heqjen e të drejtës për të pandehurin {...} për të ushtruar funksione publike për 5 vite, zbatimi i tij fillon pas vuajtjes së dënimit me burgim..., etj. etj.”

Gjithashtu më datë 17.01.2020 nga kancelaria e Gjykatës së Apelit për Krime e Renda kemi marrë një informacion në lidhje me statusin dhe gjendjen aktuale të gjykimit e cila sqaroi se: “Në Gjykatën e Apelit për Krime të Renda më datë 10.12.2019 është regjistruar çështja penale me nr.(94)/2019 akti që i përket te pandehurve {...}, {...}, {...}dhe {...}të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 319/ç -25 dhe 319 të

Kodit Penal. Kjo çështje është mbartur në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datën ... 12/18/94 akti.

Seanca e parë gjyqësore është zhvilluar në datë 07.01.2020 dhe është shtyrë për në datën 16.01.2020, për shkak të mungesës së të pandehurve {...} dhe {...}, si dhe për mungesën e mbrojtësit të të pandehurit {...}, avokatit {...}.

Seanca e dytë, është zhvilluar në datën 16.01.2020, dhe është shtyrë për në datën 29.01.2020, për shkak të mungesës së të pandehurit {...}, si dhe për mungesën e mbrojtësit të të pandehurit {...}, avokatit {...}. Çështja vazhdon në gjykim.”

Pra mbasi arsyetohet rëndësia e momentit të dorëheqjes dhe në përfundim Komisioni propozon: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, më datë 31.01.2020, për shkak të dorëheqjes së motivuar të tij nga ky status.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Kemi propozime lidhur me projekt-aktin e propozuar?

**Brikena Ukperaj:** Të pyes diçka referuar dispozitivin.

Thatë që “deklarimin e mbarimit të statusit për shkak të dorëheqjes së motivuar”. Duhet hequr. Në qoftë se do pranojmë që do mbarojë në 31, duhet hequr pjesa e motivuar.

*(S’është e motivuar – thotë zoti Toro pa ndezur mikrofonin.)*

S’është e motivuar.

Është lapsus.

**Naureda Llagami:** Po!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votim të propozimit të bërë nga...

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Pro.

*(Vota e zotit Hallunaj nuk dëgjohet.)*

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë, Këshilli vendosi: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit , në datë 31.01.2020, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 23.01.2020)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Opinion “Mbi kandidatët që kanë aplikuar për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 6. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Erion Fejzulla, USAID.*
- 10. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 12. Ama Kraja, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Opinion “Mbi kandidatët që kanë aplikuar për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Atëherë, kalojmë në çështjen e radhës të rendit të ditës e cila ka të bëjë me dhënien e opinionit mbi kandidatët që kanë aplikuar për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë, me vendimin nr. 315, datë 19.12. ka shpallur



hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e gjyqtarëve për t’u komanduar me pëlqimin e tyre në pozicionin e këshilltarit ligjor në njësinë mbështetëse të Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

Për më shumë detaje lidhur me këtë opinion ia jap fjalën zotit Alban Toro.

**Alban Toro:** Po! Konform vendimit nr. 315, datë 19.12.2019, brenda afatit të caktuar, të përcaktuar, kanë paraqitur kërkesë dy gjyqtarë:

Me shkresën nr.6526, datë 30.12.2019 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarës {...} e cila ushtron funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e shpallura për “këshilltar ligjor”;

Me shkresën nr.08, datë 06.01/2020 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarës {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dhe ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e sipërcituar.

Duke qenë se Këshilli i Lartë Gjyqësor në rastin konkret, veç shpalljes së procedurës së komandimit është njëkohësisht dhe vetë institucioni që ka nevojë për gjyqtarin e komanduar, procedura e komandimit sipas vendimit 315, datë 19.12.2019, kalon në dy faza verifikimi:

1. Në fazën e parë Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin apo kur për kandidatin verifikohet ndonjë prej kriterëve të tjera ndaluese të komandimit.

2. Në fazën e dytë procedura e komandimit vijon me vlerësimin e kriterëve të kandidimit për të gjithë kandidatët që nuk janë përjashtuar nga kandidimi në fazën e parë.

Ky vlerësim bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i cili, kur çmon të nevojshme, mund të intervistojë kandidatin për verifikimin e kriterëve të kandidimit. Intervista dokumentohet në një procesverbal me shkrim, etj.

Sa më sipër në përgatitjen e këtij opinioni për secilin kandidat, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës verifikon për secilin kandidat, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe vlerëson cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të gjykatës ku ushtron detyrën gjyqtari që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e gjyqtarit, rezulton se:

Gjyqtarja {...} fillimisht ka kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Durrës, më falni, me Dekretin e Presidentit nrr.4319, datë 17.09.2004.

Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.4655, datë 03.10.2005 është emëruar gjyqtare ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me vendimin 281, datë 14.11.2011 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ajo është transferuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe aktualisht ajo ushtron detyrën e gjyqtares. Ajo ka një eksperiencë profesionale në pune mbi 15 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është dhe as ka qenë më parë e komanduar dhe nuk ka mase disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë gjyqtare nuk ka ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Gjyqtarja {...}, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.7783, datë 10.10.2012 ka kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe më pas me dekret 8468, 23.01.2014 është emëruar përfundimisht gjyqtare ne Gjykatën e Rrethit Vlorë, ku vazhdon dhe aktualisht të ushtroje funksionin e magjistratit. Ajo ka një eksperiencë profesionale në pune mbi 7 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është dhe as ka qenë më parë e komanduar dhe nuk ka mase disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë gjyqtare nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, nga raportimet periodike dhe informacioni e mendimi i marrë nga kryetarët e gjykatave respektive rezulton se:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor ku ushtron detyrën gjyqtarja {...} ka ne organike 76 gjyqtare ndërsa efektivisht ushtrojnë funksionin 70 të tillë. Gjithashtu ka vakanca të përhershme 6 vende dhe të përkohshme 7 vende. Mesatarja e çështjeve që janë ne gjykim për 51 gjyqtarë të cilët kanë çështje civile është përafërsisht 147 çështje.

Më poshtë, më mënyrë të detajuar është dhënë ngarkesa për secilin gjyqtar në seksionin civil të kësaj gjykate.

Mesatarja e çështjeve që janë në gjykim për 51 gjyqtarë të cilët kanë çështje civile është përafërsisht 147 çështje.

Për vitin 2019 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë paraqitur vetëm katër kërkesa për caktimin gjyqtarëve nga gjykatat e tjera për gjykimin e çështjeve të ndryshme nga ato në gjykatat ku ata ushtrojnë funksionin.

Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në opinionin e tij për komandimin hipotetik të kandidatës se sipërcituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është shprehur se: “Në përgjigje të kërkesës Tuaj, ju bëj me dije se gjyqtarja (magjistratja) {...} ushtron detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë që nga data 14.11.2011, në Dhomën Civile, në seksionin tregtar, që nga momenti i krijimit të këtij seksioni. Gjatë kësaj kohe ajo ka përballuar një ngarkesë të lartë çështjesh, si në numrin e tyre ashtu dhe në kompleksitetin e çështjeve që karakterizon këtë seksion. Gjatë kësaj kohe ka punuar mire, nuk ka patur probleme. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku ushtron detyrën edhe gjyqtarja, punojnë 63 gjyqtarë. Të gjithë këta gjyqtarë kanë një ngarkesë relativisht të lartë në punë, por në kushtet kur punojnë 63 gjyqtarë, largimi i njërit prej tyre nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj gjykate, për sa kohë nuk cenohet funksionaliteti i saj, në rastin hipotetik të komandimit të gjyqtarës {...} pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Në kushtet e mësipërme Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...} në strukturat e KLGJ-së, përballë ngarkesës së çështjeve që ka kjo gjykatë dhe numrit aktual të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën pranë kësaj gjykate, nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj gjykate për sa kohë nuk cenohet funksionaliteti i saj.

Kalojmë tek Gjykata e Rrethit Vlorë ku ushtron detyrën gjyqtarja {...} e cila kjo gjykatë ka në organikë 14 gjyqtarë dhe efektivisht ushtrojnë funksionin 13, ndërkohë që një magjistrat është i komanduar pranë Gjykatës së Lartë në pozicionin e ndihmesmagjistratit konform nenit 56 të ligjit nr. 96/ 2016. Aktualisht ngarkesa në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë paraqitet e detajuar siç është më poshtë: ku {...} ka 102 çështje.

Për vitin 2019 nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Vlorë janë paraqitur vetëm pesë kërkesa për caktimin gjyqtarëve nga gjykatat e tjera për gjykimin e çështjeve të ndryshme nga ato në gjykatat ku ata ushtrojnë funksionin. Mesatarisht ngarkesë për gjyqtare është 99 çështje.

Kryetari i Gjykatës së rrethit Gjyqësor Vlorë në lidhje me rastin hipotetik të komandimit të kandidates është shprehur se: “Opinionimi im për gjyqtaren {...} është pozitiv. Që nga data e emërimit dhe deri sot ka mbuluar një volum të madh çështjes në dhomën civile të Gjykatës së Shkelës së Parë Vlorë! Opinioni im në lidhje me komandimin e saj pranë KLGJ është se një komandim i mundshëm i saj cenon funksionimin normal të kësaj gjykate për shkak të volumit të çështjeve që shqyrtohen në këtë gjykatë! Vlen të theksoj se nga gjykata që unë drejtoj është edhe një gjyqtar tjetër i komanduar prej vitesh pranë Gjykatës së Lartë! Më lejoni që me këtë rast nëpërmjet jush t’i kërkoj KLGJ që në gjykata të tilla si gjykata e Vlorës ku sipas organikes kjo gjykatë ka 14 gjyqtarë, është e tepërt dhe e papërbalueshme komandimi i dy gjyqtareve”.

Duke vlerësuar ngarkesën aktuale të gjykatës si edhe faktin se në çdo rast të cenimit të funksionalitetit komandimi mund të ndërpritet vlerësohet të vijohet me tek procedura e vlerësimit të kandidates.

Në kushtet e mësipërme Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...} në strukturat e KLGJ-së, përballë ngarkesës së çështjeve që ka kjo gjykatë dhe numrit aktual të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën pranë kësaj gjykate, nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj gjykate, për sa kohë nuk cenohet funksionaliteti i saj.

Për rrjedhim është propozuar që të vijojnë procedurat e komandimit nga

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale me vlerësimin e kritereve të tjera të komandimit për kandidatët gjyqtare: {...}; dhe vijimin e procedurave të komandimit nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale me vlerësimin e kritereve të tjera të komandimit për kandidatët gjyqtarë: {...}.

Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kemi, para se ta kalojmë në votim, kemi ndonjë diskutim lidhur me opinionin?

Po, zonja Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Doja të shfaqja mendimin tim lidhur me cenimin ose jo të funksionalitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nëse do të vijohet me procedurat e komandimit për gjyqtaren {...}.

Së pari, referuar ngarkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është llogaritur mesatarja 99 çështje referuar të gjithë gjyqtarëve. Por Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë gjykon me dy dhoma (dhomë civile dhe dhomë penale) dhe gjyqtarët e dhomës civile, duke qenë se edhe tek Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale marrim në mënyrë periodike raportim nga kryetarët e gjykatave, gjyqtarët e dhomës civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë janë zoti {...} që ka një ngarkesë aktuale 185 çështje; gjyqtarja {...} që ka një ngarkesë aktuale 102 çështje; gjyqtari {...} ka një ngarkesë aktuale 218 çështje; gjyqtarja {...} ka një ngarkesë aktuale 147 çështje; gjyqtare {...} ka 106 çështje dhe gjyqtare {...} ka 98 çështje.

Ndërkohë që për gjyqtaren {...}, vet Këshilli ka miratuar komandimin e saj në Këshill, efektet e të cilit fillojnë në muajin mars të vitit 2019, çka do të thotë që 147 çështjet që ajo ka për shqyrtim, do të rishpërndahen midis 5 gjyqtarëve të tjerë dhe në një llogaritje matematikore, do të shkojë edhe kjo ngarkesë mbi 150 çështje për gjyqtar (Gjyqtarët e tjerë që kanë po ngarkesën e gjyqtarëve të dhomës penale të Gjykatës së Vlorës).

Referuar kësaj llogaritjeje, referuar faktit që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në qoftë se do të vijojnë procedurat e komandimit edhe për gjyqtaren {...}, do të ketë tre gjyqtarë të komanduar dhe nga ana tjetër, plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, krahasuar me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është më i vështirë, se nuk ka pozicion të lirë të përhershëm, janë pozicione të lira të përkohshme.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shumë pozicione të lira të përhershme dhe mundësia e Këshillit për të transferuar gjyqtarë në këtë gjykatë është më e madhe referuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Referuar këtij arsyetimi si dhe referuar edhe mendimit që ka dhënë kryetari, unë do të propozoja që zonja {...} të përjashtohet nga kandidimi për komandim që në këtë moment të miratimit të opinionit, për shkak se komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku ajo ushtron funksionin sepse cenon ose dëmton funksionalitetin e saj; dhe të vazhdojnë procedurat e komandimit vetëm për gjyqtaren {...}.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Kemi ndonjë mendim tjetër.

Po, zoti Toro!

**Alban Toro:** Më duhet ta kundërshtoj këtë sepse mori në konsideratë disa shifra të cilat përfaqësojnë, le të themi, ngarkesën respektive të Gjykatës Vlorë, ndërkohë që në një diskutim të mëparshëm u konsiderua e tepërt ngarkesa, le të themi, e Gjykatës së Fierit me 121 çështje maksimalisht; ndërkohë që gjykata aktualisht, Gjykata e Vlorës, në vlerën më maksimale që ka dhe përfaqësohet ngarkesa që ka zonja {...}, ka 147 çështje; ndërkohë që në rastin konkret Gjykata e Rrethit Tiranë, kandidatja që ne propozojmë, kandidatja e mundshme, ka 219 (në mos u gabofsha) çështje në gjykim. Pra që është një vlerë relativisht goxha e madhe.

Në momentin që është gjykata më, të themi, për nga pikëpamja e karrierës është gjykata më e specializuar, po t'i futemi këtyre diskutimeve, ka të themi, një cenim të funksionalitetit të saj apo të cilësisë së personave që largohen nga kjo gjykatë.

Kështu që, po të vlerësojmë statistikën, më dalin që pak a shumë, në të dy krahët

prishet funksionaliteti, nëse do të fillojmë të flasim në këto parametra. Kjo ishte për sa i përket...

*Naureda Llagami:* Ndonjë diskutim tjetër?

Atëherë, mendoni që të kalojmë fillimisht propozimin të bërë nga zonja Ukperaj, e cila propozon që të vijojë komandimi, procedura për komandimin vetëm për kandidaten {...} dhe jo për kandidaten {...}, për shkak të cenimit të funksionalitetit të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

Hedhim në votim propozimin.

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Ilir Toska:* Kundër.

*Alban Toro:* Kundër.

*Fatmira Luli:* Pro.

*Marçela Shehu:* Kundër.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi opinionin me ndryshimin që procedurat për komandimin të vazhdojë vetëm për gjyqtaren {...}

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 23.01.2020)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Mbi propozimin e Komisionit të Disiplinor lidhur me:

1. Projektvendimin “Për shkarkimin e z. {...} nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë”;
2. Projektvendimin “Për deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqjeje, të gjyqtarit {...}”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |



- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>11. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 6. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 7. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 8. Gentiana Bigu , Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 9. Erion Fejzulla, USAID.**
- 10. Gregor Borkowski, EURALIUS.**
- 12. Ama Kraja, OSCE.**

#### **RENDI I DITËS:**

9. Mbi propozimin e Komisionit të Disiplinor lidhur me:

1. Projektvendimin “Për shkarkimin e z. {...} nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë”;
2. Projektvendimin “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqjeje, të gjyqtarit {...}”.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me propozimin e ardhur nga Komisioni i Disiplinës për zotin {...}.

Unë dëshiroj t'ia jap fjalën kryetarit të Komisionit të Disiplinës, zotit Medi Bici.

**Medi Bici:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Gjyqtari {...} është emëruar në vitin 1993 si ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, po në këtë vit, në tetor të këtij viti është emëruar gjyqtar po në këtë gjykatë. Në vitin 1995 ka kaluar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe me shpërndarjen e Gjykatës së Apelit Tiranë, si gjykatë unike në vend (në 6 gjykata) ai është emërua në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, më parë si gjyqtar, pastaj është bërë edhe kryetar gjykate.

Më vonë, zoti {...} ka kaluar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës dhe nga viti 2013 kryente detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Në nëntor të vitit 2017, gjyqtari {...} është akuzuar për veprën penale të korrupsionit dhe ndaj tij është marrë masa e sigurimit “arrest në burg”, prandaj Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 57, ka vendosur ta pezullojë përkohësisht nga detyra gjyqtarin {...}, për shkak se ai ka marrë masë sigurimi “arrest në burg”.

Pas përfundimit të shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin nr. 151, datë 21.12.2016 ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit {...} për kryerje të veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç të Kodit Penal, dënimin e tij me 3 (tre) vjet e 9 (nëntë) muaj burgim”.

Në bazë të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit {...} i ulet një e treta e dënimit dhe dënohet përfundimisht me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Vuajtja e dënimit të pandehurit i fillon nga dita e ndalimit më datë 09.11.2017 dhe i është hequr zotësia për të ushtruar funksione publike, për një kohë prej 3 (tre) vjet, bazuar në nenin 35/2 të Kodit Penal, zbatimi i të cilit do të fillonte pas vuajtjes së dënimit me burgim.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, me vendimin nr. 18, datë 27.02.2019 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. 129, datë 27.11.2018 të Gjykatës së Shkallës së

Parë për Krime të Rënda, për sa i përket deklarimit fajtor dhe cilësimit juridik të veprës penale, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, për të pandehurin {...}.

Ndryshimin e vendimit nr. 129, datë 27.11.2018 të Gjykatës për Krime të Rënda në lidhje me masën e dënimit, duke e dënuar atë sipas neneve 319/ç e 49 të Kodit Penal me 3 (tre) vjet burgim.

Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri {...} dënohet me 2 (dy) vjet burgim.

Lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera të tij.

Pas përfundimit të çështjes penale, në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda me datën 18.03.2019 ka depozituar pranë Këshillin e Lartë Gjyqësor shkresën nr. 27/10, datë 15.03.2019 për ekzekutimin e vendimit penal nr. 18, datë 27.02.2019 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

Komisioni i Përhershëm i Disiplinës ka konstatuar se me vendimin e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda nr. 18, datë 27.02.2019 i cili ka lënë pjesërisht në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda nr. 129, datë 27.11.2018, gjyqtari {...} rezulton fajtor dhe është dënuar përfundimisht me 2 (dy) vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

Sipas parashikimeve të bëra në Kodin e Procedurë Penale, vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë, prandaj si i tillë ai përbën titull ekzekutiv dhe duhet vënë në ekzekutim. Vepra penale për korrupsion të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të drejtësisë, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal për të cilin është dënuar gjyqtari {...} është një krim i kryer me dashje direkte dhe parashikon si marzhe dënimi nga 3 vjet deri në 10 vjet burgim.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 140, paragrafi 2, shkronja b, parashikon se: Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Në rastin në shqyrtim sipas vendimit nr. 18, datë 27.02.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda rezulton se gjyqtari {...} është dënuar me 2 (dy) vjet burgim për

kryerjen e një krimi, prandaj, në zbatim të nenit 140/2, shkronja /b/ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i Përhershëm i Disiplinës i ka rekomanduar Këshillit të Lartë Gjyqësor shkarkimin e gjyqtarit {...} nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Pas bërjes së relacionit dhe dorëzimit të vendimit, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, më datë 09.04.2019 është regjistruar kërkesa e datës 08.04.2019 që ka bërë gjyqtari {...}, i cili thotë: “Unë {...} {...}{...}, me detyrë gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë, me vullnet të plotë, dorëhiqem sot më datë 08.04.2019. Pavarësisht faktit se ndaj meje ka një akt pezullues të përkohshëm, ushtrimi i detyrës, i ndërmarrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD), me vendimin nr. 57, datë 17.11., si dhe një proces penal ende në ndjekje e në fazë rekursi pranë Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, vendosa dorëheqjen i vetëdijshëm për çdo pasojë të saj, mbështetur në gjendjen time shëndetësore dhe kushtet familjare përkatëse.

Ky akt ju njoftohet zyrtarisht në përputhje me nenin G të Aneksit të Kushtetutës të miratuar me ligjin 76/2016, datë 22.07.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Pasi u paraqit kërkesa për dorëheqje, Komisioni i Përhershëm i Disiplinës ka përgatitur edhe dy relacione që është e njëjta gjë në fakt, një relacion (varianti i parë) është dorëheqja e gjyqtarit {...} ku janë pasqyruar neni 64 i ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve”, ku sipas tij thuhet: “Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen; b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; c) mbush moshën e pensionit; ç)..”

Ndërkohë, neni 65 në të njëjtin ligj ku rregullohet forma, koha dhe mënyra e paraqitjes së dorëheqjes, kërkon domosdoshmërisht që ajo të jetë më shkrim. Konkretisht, neni 65 citojmë:

1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.

2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr

deklarimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Për këto që thamë, Komisioni i Disiplinës i vjen Këshillit me dy kërtime. Fillimisht ne jemi të detyruar që të hedhim në votim dorëheqjen e gjyqtarit {...} dhe nëse kjo nuk merr votat e duhura, të hedhim variantin tjetër që është shkarkimi i gjyqtarit.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me propozimin e bërë nga Komisioni i Disiplinës?

Komisioni ka ardhur me dy propozime.

**Medi Bici:** Data se kur i përfundon statusi, e kemi lënë të pacaktuar, për arsye sepse sipas ligjit, ... i bie data 31.05.2019 sepse kërkesa është paraqitur më 08.04.2019. Ky është rregullimi që duhet të bëjmë.

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Atëherë, në lidhje me propozimin që ka të bëjë me shkarkimin nga detyra të zotit {...}, shkarkimi është masë disiplinore dhe për këtë arsye duhet të ketë një proces disiplinor. Nuk besoj se ligji ngarkon ndonjë prej strukturave të Këshillit të propozojë masa disiplinore. E ka përcaktuar Kushtetuta se kush e propozon masën disiplinore, është Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Në këtë kuptim ne nuk mund të, mendoj unë, që Këshilli të marrë një masë disiplinore, pa pasur një proces disiplinor dhe fillimisht pa pasur një kërkesë për procedim disiplinor.

Pavarësisht se në hipotezë masa e shkarkimit është e përcaktuar nga Kushtetuta, në rastet e dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë, gjithsesi në pikëpamjen time duhet të ketë një procedim disiplinor.

Këshilli nuk mund të veprojë kryesisht dhe ta marrë vet masën disiplinore.

Sa i përket kërkesës për dorëheqje, ajo është një kërkesë që tashmë i ka dhënë efektet e saj, është paraqitur që në muajin prill dhe nëse nuk pranojmë që ka një procedim disiplinor, pra nuk ka ndonjë pengesë që ne të deklarojmë mbarimin e statusit për shkak

dorëheqjeje, do duhet të pranojmë propozimin e dytë për mbarimin e statusit pikërisht për shkak të dorëheqjes.

Gjithsesi, nëse edhe anëtarët e tjerë mendojnë, mund të jetë i zbatueshëm në rastin konkret edhe neni 66 për mbarimin e statusit, pikërisht për shkak të verifikimit të një kushti pazgjedhshmërie që është pikërisht qenia i dënuar.

Neni 66 referon te neni 28 dhe neni 28, ndër të tjera, si kriter zgjedhshmërie, ka përcaktuar edhe mosqenien i dënuar penalisht.

Gjithsesi kjo është një çështje që mund ta konsideroj Këshilli. E gjithë ajo që unë mendoj është që duhet të ndjekim një lloj procedure, ndërsa nuk mund të ndjekim një procedurë disiplinore, duhet të ndjekim një procedurë administrative, ku magjistratit t'i garantohet e drejta që ligji i njeh çdokujt në një procedurë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Po, zoti Medi!

**Medi Bici:** Unë e kam atë dilemë që thotë zoti Ilir, në lidhje me variantin e parë që shtrua për shkarkimin. Por duhet të kemi parasysh parashikimet që bën neni 4, pika e ligjit nr. 96/2016 për Statusin, i ndryshuar me ligjin 48/2019 i cili parashikon: Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi.

Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji, zbatohen për aq sa janë të nevojshme. Dhe e dyta, neni 139/1, pika /b/ i ligjit nr. 96/2016, parashikon se: Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore, nëse çështja ka qenë objekt i procedimit disiplinor, që është zgjidhur me vendim të formës së prerë.

Ka pas edhe dy raste praktika, që është rasti i ish-gjyqtarit {...} dhe i gjyqtarit Ibrahim Hoxha, që i ka marrë ish-KLD-ja, por janë marrë në vitin 2017 kur ka pas hyrë në fuqi korpusi i ri ligjor, dhe qëndrimi që duhet të mbajmë në rast, se ndoshta s'arrijmë, është që ën fakt, në rastet kur ka një vendim dënimi të formës së prerë, procedimi disiplinor, jam dakord me Ilirin, procedimi disiplinor, është krejt formal.

Por ka përfunduar.

**Naureda Llagami:** Po, zonja Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Ajo që edhe Iliri tha dhe çështja që shtrohet për diskutim është që Kushtetuta do të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo do të kemi në të gjitha rastet edhe kur kemi një vendim të formës së prerë për shkarkim, inicimin e një procedimi disiplinor? Kjo është një çështje që duhet të diskutojmë. Dhe e dyta pastaj, duhet të diskutojmë që në çfarë momenti mbaron sepse mbarimi i statusit me shkarkim është një mënyrë tjetër e mbarimit të statusit nga mbarimi i statusit me dorëheqje, dhe në ç'moment kjo dorëheqje do të shkaktojë efekte dhe a do ta marrë Këshilli në konsideratë dorëheqjen e gjyqtarit pasi vendimi ka marrë formë të prerë?

Duke qenë se ka disa diskutime, unë do të propozoj që para se të arrinim në një vendimmarrje, t'i kërkonim një mendim edhe dy misionëve mbështetëse - siç kemi bërë edhe për raste të tjera kur kemi patur, marrë rastin e inspektorëve për shembull, kur e kemi patur çështje të diskutueshme - çështjen se si duhet të operojmë në kushtet kur Kushtetuta parashikon në mënyrë të shprehur që gjyqtari shkarkohet pas një vendimi për kryerjen e një krimi me formë të prerë dhe ndërkohë që pranë Këshillit nuk kemi pasur ende një procedim disiplinor.

Nuk ka procedim disiplinor. Ka hetim disiplinor.

Procedim disiplinor nuk ka.

I vetmi organ që inicion procedimin disiplinor është Inspektori. Këshilli vet nuk mund të fillojë një procedim disiplinor. Ky është propozimi im.

**Brunilda Kadi:** Edhe unë jam dakord me atë që sapa tha Brikena. Por ajo që unë e kam të diskutueshme është që a bëhet shkarkimi për shkak të dënimit me vendim të formës së prerë për një krim vetëm me inicim të Inspektoratit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo bëhet kryesisht edhe nga Këshilli? Sepse mund të jetë rasti i tillë. Kur një veprim i caktuar mund të përbëjë elementet e një vepre penale, por Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk fillon procedim disiplinor sepse veprimi mund të mos përbëjë, në pamje të parë mund të mos ketë lidhje me shkeljet disiplinore, le të themi për shembull "shkelje e rregullave të qarkullimit ligjor", që do të thotë, nëse nuk vjen asnjëherë ILD-ja me propozim, nuk nis procedim...

Është krim. Krim me pasojë vdekje.

Atëherë nëse ILD-ja nuk nis asnjëherë hetim dhe nuk vjen, s' 'inicion procedimin, Këshilli a ka të drejtë që të bëjë një procedim vet në këtë kuadër? Dhe kjo është dilema.

Ideja është që vet, pra në një rast të tillë, në një kazus të tillë, kur dënohet për një krim, por nuk ka nisur procedim disiplinor nga ILD-ja ose nuk nis asnjëherë, vet Këshilli ka detyrim që të bëjë procedurë dhe të vendosë shkarkimin?

Edhe unë jam dakord që të merret një mendim nga dy misionet.

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** S'kam asnjë objeksion.

Le të kërkohet opinion nga të dy misionet që na mbështesin.

Por nëse do konsiderojnë edhe anëtarët e tjerë këtë gjë, mundet që të marrim për efekt të dokumentacionit në dosje edhe një konfirmim nëse vazhdon ende procesi penal. Pra jemi para faktit që ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, por ngaqë nuk ka informacion aty, nuk e kuptoj nëse është vendim përfundimtar. A ka rekurs në Gjykatë të Lartë që në një situatë të mundshme mund të...

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat që ka rekurs.)*

Gjithsesi mund ta marrim zyrtarisht edhe një konfirmim, të jetë pjesë e dosjes që ta trajtojmë edhe këtë rrethanë, që nëse ka rekurs, si pjesë e të gjithës. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në votim propozimet e bëra, së pari, për të marrë në mënyrë zyrtare faktin që ndaj vendimit penal të apelit ka ushtruar rekurs apo jo në Gjykatën e Lartë, për zotin {...}. Dhe së dyti, t'i japim mundësi, që lidhur me këtë çështje, të na japin një opinion më të specializuar, të dy partnerët tanë që na asistojnë gjatë punës tonë, Projekti EURALIUS dhe Projekti "Drejtësi për të gjithë".

Jeni dakord që ta shtyjmë shqyrtimin e kësaj nëse?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.



*Fatmira Luli:* Pro.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, shqyrtimi i kësaj çështjeje shtyhet deri në momentin kur ne të marrim si mendimin ashtu edhe dokumentacionin nga Gjykata e Lartë dhe e fusim në rend dite më pas.

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 23.01.2020)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe transferimin e gjyqtares znj. {...}”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 6. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Erion Fejzulla, USAID.*
- 10. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 12. Ama Kraja, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe transferimin e gjyqtarës znj. {...}”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e radhës e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar dhe transferimin e gjyqtares znj. {...}”, relator i këtij projekt-akti është zoti Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, ky relacion është përpiluar në bazë të nenit 147, pika 1, 147/a, shkronja “a” dhe nenin 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 44, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 162, pikat, 1, 3 dhe 4, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 286, datë 18.12.2019 ka vendosur fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 19.12.2019. Sipas këtij vendimi Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për shkak të fillimit të funksionimit të kësaj gjykate, duke qenë përpara detyrimit ligjor mbi caktimin e gjyqtarëve në detyrë të Gjykatës së Krimeve të Rënda përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, në varësi të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor mori vendimin nr.298, datë 18.12.2019, “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtares znj. {...}”. Caktimi i përkohshëm i kësaj gjyqtare u bë në kushtet e parashikuara nga neni 162, pika 3, e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi rezultoi se ndaj saj kishte filluar procesi i rivlerësimit, sipas përcaktimeve të ligjit “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mirëpo në datën 18.12.2019 ende nuk kishte një vendim të formës së prerë për konfirmimin e saj në detyrë, ndërkohë që ajo dhe familjarët e saj kishin dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Rezulton se, më datë 17.01.2020, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pas përfundimit të seancës dëgjimore, ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të

rivlerësimit, znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda...”

Në këto kushte, bazuar në neni 162, pika 4 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, që përcakton se: “...Në rast se ndaj gjyqtarit të caktuar përkohësisht, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendoset masë disiplinore, në bazë të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, caktimi i përkohshëm i tij mbaron pavarësisht nëse është bërë ose jo ankim ndaj këtij vendimi”, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të vendosi deklarin e mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtares znj. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për deklarin e mbarimit të caktimit të përkohshëm dhe transferimin e gjyqtares znj. {...}”, ku në pikën 1 të projektvendimit është parashikuar pikërisht deklarimi i mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtares znj. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Nga ana tjetër, Këshilli i Lartë Gjyqësor obligohet të caktojë gjyqtaren znj. {...} në një pozicion tjetër të të njëjtit nivel gjykate, por me juridiksion të përgjithshëm, për sa kohë ajo, pavarësisht masës disiplinore të dhënë me një vendim që ende nuk është përfundimtar dhe pezullimit ex lege nga detyra e saj në pritje të vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit në rast ankimimi të tij, sikurse përcakton neni 62, pika 1, i ligjit të Statusit (*lapsus, pasi është sipas ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*), ajo vijon të ruajë statusin e magjistratit dhe të gëzojë të drejtën e pagës në masën 75 për qind të saj, sikurse përcakton kjo dispozitë e ligjit, por edhe neni F, pika 5, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në kushtet kur gjyqtarja znj. {...} është në pritje të arsyetimit të vendimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa gëzon të drejtën e ankimit të tij përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe ajo nuk ka të drejtë të shqyrtojë dhe të gjykojë çështje, por gëzon vetëm të drejtën e pagës, duke konsideruar

mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndërsa ka detyrimin për të caktuar në një pozicion pune gjyqtaren në fjalë, do të duhet të konsiderojë po ashtu edhe funksionalitetin e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm ku gjyqtarja duhet të caktohet, në kuptimin që caktimi i saj në pozicion të mos pengojë plotësimin e vakancave emergjente në këto gjykata.

Në pikën 2 të projektvendimit, është përcaktuar, por e papërcaktuar gjykata, por është përcaktuar që të transferohet në një gjykatë të rrethit gjyqësor, duke filluar nga data 18.01.2020 (që është dita e nesërme e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ën fakt është është edhe ditë e shtunë dhe Këshilli mund ta konsideroj këtë moment) dhe deri në përfundimin, me vendim të formës së prerë, të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj saj sipas ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Një transferim i tillë i gjyqtarës znj. {...} garanton të drejtën aktuale që ajo gëzon nga pasja e statusit të magjistratit, pra të drejtën e pagës.

Nga ana tjetër, për garantimin e të drejtave që znj. {...} i rrjedhin nga statusi i magjistratit, të cilat bëhen efektive vetëm në rast të ankimimit të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe, më tej, konfirmimit të saj në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në pikën 3 të projektvendimit është parashikuar se ajo, në një rast të tillë, gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion, që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve, në gjykatat e shkallës së parë me juridiksionin të përgjithshëm, sikurse një gjë të tillë magjistratit ia garanton neni 44, pika 2, shkronja "b", e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", duke patur në konsideratë se transferimi i znj. {...} është pa pëlqim në kushtet kur për shkak të ligjit ajo ka dhënë pëlqim që të vijojë punën si gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në pikën 4 të projektvendimit parashikohet se një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e

qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku do të vendoset që ta caktojme ta transferojme.

Në pikën 5 të projektvendimit parashikohet e drejta dhe afati i ankimit të gjyqtarës, konkretisht se kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Së fundi, projektvendimi përcakton hyrjen në fuqi menjëherë të tij, si dhe publikimin e vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, jeni dakord me projekt-aktin?

Duhet të propozoni edhe gjykatën.

**Ilir Toska:** Atëherë, vende të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Okej, këto janë vendet vakante që janë.

Atje ku mund ta çojmë janë vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, Elbasan dhe Tiranë.

Mbajmë në konsideratë se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, disa ditë më përpara bëmë transferimin e gjyqtarit {...}i cili nuk do ushtrojë detyrën por thjesht do duhet t’i garantohet e drejta e pagës, ndërsa është në proces apelimi përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, keni ndonjë propozim konkret?

**Dritan Hallunaj:** Propozoj Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**Naureda Llagami:** Jeni dakord me propozimin e projekt-aktit të bërë nga Komisioni dhe propozimin e zotit Hallunaj që gjykata në të cilën do transferohet do jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Unë mendoj që duhet parë. Sa vende bosh ka Elbasani?

Dy? I ka dy?

Okej, dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtares znj. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Transferimin e gjyqtares të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan duke filluar nga data 18.01.2020 (ditë e shtunë) dhe deri në përfundimin, me vendim të formës së prerë, të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj saj sipas ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Në rast të ankimit të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimit në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, gjyqtarja znj. {...} gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion, që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritët të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve, në gjykatat e shkallës së parë me juridiksionin të përgjithshëm, sikurse një gjë të tillë magjistratit ia garanton neni 44, pika 2, shkronja "b", e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.



Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

\* \* \*

(Pika 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 23.01.2020)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarës znj. {...}”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 6. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Erion Fejzulla, USAID.*
- 10. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 12. Ama Kraja, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarës znj. {...}”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}”. Relator i këtij projekt-akti është sërish zoti Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, nga Komisioni është përgatitur projektvendimi “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarës znj. {...}”. Edhe ky relacion është bazuar në nenin 135, 135, pika 4, 147, pika 1, 147/a, shkronja “a”, 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 162, pika 2, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 286, datë 18.12.2019 ka vendosur fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ndërsa, për shkak të fillimit të funksionimit të kësaj gjykate, prej datës 19 dhjetor Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur me vendimin nr.293, datë 18.12.2019, “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme (*lapsus, pasi është në mënyrë të përkohshme*), në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarës znj. {...}”, gjyqtare në atë moment në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Caktimi i përkohshëm i kësaj gjyqtare u bë në kushtet e parashikuara nga neni 162, pika 3, e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve”, pasi rezultoi se ndaj saj kishte filluar procesi i rivlerësimit, sipas përcaktimeve të ligjit “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mirëpo në datën 18.12.2019 ende nuk kishte një vendim të formës së prerë për konfirmimin e saj në detyrë, ndërkohë që ajo dhe familjarët e saj kishin dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Tashmë rezulton se znj. {...} ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit sipas përcaktimeve të ligjit "Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ndërsa është konfirmuar në detyrë me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr.208, datë 08.11.2019, vendim ky që ka marrë formë të prerë pa u ankimuar, më datë 31.12.2019. Ky fakt, pra mosparaqitja ankimi ndaj vendimit si më lart të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konfirmohet edhe nga njoftimi publik i datës

27.12.2019 i Institucionit të Komisionerëve Publikë për mosankimim të vendimit të dhënë për subjektin e rivlerësimit znj. {...}.

Në këto kushte, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin ligjor për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtares znj. {...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në rrethanat kur plotëson kushtet e kërkuara nga ligji, neni 162, pika 2, i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi:

a) ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të ligjit "Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ndërsa është konfirmuar në detyrë me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr.208, datë 08.11.2019, vendim i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar;

b) përmbush kriteret për ngritjen në detyrë, sipas përcaktimeve të nenit 47, pika 2, shkronja “a” , të këtij ligji, ndërsa ka ushtruar funksionin e gjyqtarit jo më pak se shtatë vjet, konkretisht mbi 16 vjet, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtare në fushën e drejtësisë kriminale;

c) ajo dhe familjarët e afërm të saj kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të saj bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" (rrethanë kjo e verifikuar në rastin e caktimit të përkohshëm sipas vendimit nr.293, datë 18.12.2019 të KLGJ-së).

Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtares znj. {...}”. Bashkëlidhur keni edhe projektvendimin përkatës. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Jo!

Kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga relatori dhe Komisioni përkatës.

**Maksim Qoku:** Dakord.

*(Vota e zonjës Kadi nuk dëgjohet.)*

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtares znj. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

\* \* \*

(Pika 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 23.01.2020)*

**Pika 12 shtesë e rendit të ditës me objekt:** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 6. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Erion Fejzulla, USAID.*
- 10. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 12. Ama Kraja, OSCE.*

#### **RENDI I DITËS:**

12. Pikë shtesë - Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Tani, sipas rendit ne kishim pikën 12, por duke qenë se diskutimin e kësaj pike ne e bëjmë me dyer të mbyllura, bëjmë hedhjen e shortit për caktimin në gjykatën e apelit dhe më pas njoftojmë edhe partnerët këtu të largohen, për të vazhduar me diskutimin e pikës së fundit.



Atëherë, për shqyrtimin e projekt-aktit lidhur me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme, nga ajo ku shtrajnë funksionet në mënyrë të përhershme, ia jap fjalën zotit Ilir Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, ditën e djeshme datë 22 janar 2020 nga Gjykata e Apelit Shkodër ka ardhur një kërkesë përmes të cilës ajo kërkon caktimin e një gjyqtari, ndërsa ka nevojë për shqyrtimin e një çështjeje që ka të bëjë me zëvendësim mase sigurimi, në lëndë penale.

Në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, shkak për të cilin Këshilli do duhet të konsiderojë mekanizmin e caktimit të një gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhet me short gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Durrës dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje, të jetë aq sa kërkon gjykata, pra 1 gjyqtar.

Lidhur me propozimin konkret, Komisioni i referohet rrethanave të rastit të bëra me dije nga Gjykata e Apelit Shkodër. Sipas informacionit të marrë nga kjo gjykatë me vendimin nr. 211, datë 11.10.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar zoti Izet Dushaj në çështjen administrative penale me të pandehur (janë emrat e të pandehurve përkatës) ku ka gjykuar në hetimet paraprake dhe është shprehur me vendimin nr. 334, datë 06.12.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër me trup gjykues të përbërë, krahas gjyqtarit të komanduar nga Gjykata e Apelit Durrës z. Izet Dushaj, edhe nga gjyqtarët Aleks Nikolli dhe Vojsava Osmanaj.

Në këtë rast, çështja ka pasur të bëjë, objekti i kërkesës ka qenë “dërgimi i çështjes në gjyq”.

Ndërkohë që çështja ka qenë në sekretari të Gjykatës së Apelit Shkodër, në pritje të përfundimit të afateve të ankimit, nga ana e një prej të pandehurve në këtë rast është paraqitur kërkesë për “zëvendësim mase sigurimi”.

Referuar kësaj situate, ndërsa masa e sigurimit, sipas parimit procedural gjykohet nga gjykata ku janë aktet është sugjeruar edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër të caktohet rishtazi zoti Dushaj nga Gjykata e Apelit Durrës, për të shqyrtuar edhe kërkesën që është paraqitur në këtë rast për “zëvendësimin e masës së sigurimit” nga një nga të pandehurit.

Për rrjedhojë, propozimi i Komisionit është që: Për 1 çështje, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, mbështetur në rrethanat e rastit të referuara nga gjykata në nevojë, si përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari Izet Dushaj, i Gjykatës së Apelit Durrës, në respektim të parimit procedural se kërkesat në lidhje me masat e sigurimit shqyrtohen nga gjykata ku janë aktet. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, e hedhim në votim propozimin e bërë nga relatori?

**Maksim Qoku:** Dakord.

*(Vota e zonjës Kadi nuk dëgjohet.)*

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi të caktojë gjyqtarin për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatën në nevojë si vijon: Gjykata e Apelit Shkodër: Gjyqtari i Gjykatës së Apelit, 1 (*Izet Dushaj*), caktohet në përbërjen e trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me kërkuar {...}, me objekt: “Zëvendësim mase sigurimi”.

Izet Dushaj.

Atëherë, përcaktohet gjyqtari Izet Dushaj, i cili është edhe gjyqtari që ka gjykuar... caktohet në përbërjen e trupit gjykues për të gjykuar për llogari, çështjen gjyqësore me kërkues {...}, me objekt: “Zëvendësim mase sigurimi”.

Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare.

\* \* \*

(Pika 12 shtesë e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**